

VENDIM
Nr. 113, datë 17.2.2021

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT UDHËZUES TË POLITIKAVE MBI ZONAT E
PËRCAKTUARA PËR AKUAKULTURË (ZPA) NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**IDENTIFIKIMI I ZONAVE TË PËRCAKTUARA PËR AKUAKULTURË NË ZONËN
BREGDETARE TË SHQIPËRISË (PZA Rajonale Sarandë)**

Dokument udhëzues i politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri

Projekti: “Mbështetje për Sektorin e Peshkimit në Shqipëri” Ref. EuropeAid/155184/Act/AL

Nëntor 2020

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Lista e figurave

i. Akuakultura: Një vështrim në nivel global dhe rajonal

ii. Zonat e përcaktuara për akuakulturën (ZPA) në Shqipëri

iii. Masat dhe identifikimi i zonave për miratimin e zonave të përcaktuara për akuakulturë përgjatë bregdetit shqiptar

1. SEKSIONI I

1.1 PJESA I

Objekti dhe qëllimi

Përkufizime

1.2 PJESA II

Menaxhimi dhe monitorimi i akuakulturës në ZPA

1.3 PJESA III

Masat e parashikuara për ZPA-të

1.4 PJESA IV

1.5 PJESA V

1.5.1 ZPA-të për zonën bregdetare të Sarandës

Kategoria 01 e ZPA për peshqit

2. SEKSIONI II

2.1 Hyrje

2.2 Akuakultura në Shqipëri

2.3 Kuadri ligjor për ZPA-të në Shqipëri

2.4 Kuadri ligjor për akuakulturën në Shqipëri

2.5 Autoritetet kryesore përgjegjëse për akuakulturën dhe aktorët e tjerë kyç

2.6 Metodologjia për përzgjedhjen e ZPA-ve

2.6.1 Vlerësimi i shkallës së pajtueshmërisë

2.6.2 Faktori i peshimit (Ki)

2.6.3 Indeksi i përshtatshmërisë (SIi)

2.6.4 Skenari dhe parametrat e marrë në konsideratë

Batimetria

Lloji i shtratit të detit

Zonat e mbrojtura detare

Zonat e peshkimit artizanal

Zonat e zhytjes

Shkarkimet e ujërave të përdorur

Zonat turistike

Largësia nga porti më i afërt

Grykëderdhjet e lumenjve

Kanalet e lagunave

Vija bregdetare

Korridoret detare

Tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit

Dallgëzimi

Shpejtësia e rrymave

Temperatura e ujit në sipërfaqe

Klorofili a

2.6.5 Përmbledhje e parametrave të marrë në konsideratë për akuakulturën e peshqve dhe molusqeve

2.6.6 Kapaciteti mbajtës i prodhimit

2.6.7 Plani i monitorimit të mjedisit (PMM)

Bibliografia

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument është një udhëzues i politikave për planifikimin e zonave të përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën” (Republika e Shqipërisë, 2016), i cili synon të sigurojë një zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit. Krijimi i ZPA-ve do të siguronte një integrim më të mirë të akuakulturës në zonat bregdetare dhe është një parakusht për dhënien e licencave dhe qirave të reja për akuakulturë.

Puna është realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) në kuadër të projektit “Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri” (EuropeAid/155184/Act/AL) dhe posaçërisht nën aktivitetin 1.10 – “Hartimi i planit mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) bazuar në udhëzimet dhe metodologjitë përkatëse”. Aktivitetet u ndërmorën në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) brenda kuadrit të bashkëpunimit me Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM), dhe në bashkëpunim me Ministrinë Italiane të Politikave të Bujqësisë, Ushqimit dhe Pylltarisë (MIPAAF).

Ky dokument udhëzues i politikave është strukturuar në dy pjesë: pjesa e parë paraqet rezultatet kryesore me hartat e ZPA-ve përgjatë bregdetit shqiptar, ndërsa pjesa e dytë përshkruan metodologjinë e aplikuar, si dhe informacioni tjetër thelbësor mbi të cilin është bazuar përzgjedhja e ZPA-ve.

ZPA-të përgjatë zonës bregdetare të Shqipërisë janë grupuar në katër nënzona të mëdha që janë: 1) Shëngjini, 2) Durrësi, 3) Vlora, dhe 4) Saranda.

Për qëllimet e këtij dokumenti udhëzues të politikave, ZPA-të janë marrë në konsideratë për ato aktivitete të akuakulturës, të cilat lejohen sipas ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, dhe janë përcaktuar si më poshtë:

- kategoria 01 e ZPA-ve – peshqit
- kategoria 02 e ZPA-ve – molusqet

Sa i takon kategorisë 01 të ZPA-ve – peshqit, është identifikuar në 1 ZPA me një shtrirje totale prej 5 km², dhe një prodhim potencial total vjetor të vlerësuar në 2000 tonë peshk, bazuar në kapacitetin mbajtës.

Për më tej, janë dhënë rekomandime për: (i) ndjekjen e zhvillimit të akuakulturës në ZPA përmes një sistemi monitorimi të bazuar te treguesit; (ii) krijimin e sistemeve të monitorimit mjedisor për të siguruar qëndrueshmërinë mjedisore.

Gjithashtu, është dhënë edhe një përshkrim gjithëpërfshirës i metodologjisë për të identifikuar ZPA-të, si dhe janë paraqitur referencat e përdorura.


Lista e figurave

Figura 1: Identifikimi i kategorisë 01 të ZPA – peshqit në zonën e Sarandës 28

i. Akuakultura: Një vështirësi në nivel global dhe rajonal

Akuakultura, në të gjithë botën, konsiderohet si një nga sektorët me rritjen më të shpejtë të prodhimit të ushqimit, duke kontribuar në sigurinë ushqimore, punësimin dhe zhvillimin ekonomik, dhe kjo prirje globale parashikohet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Sipas statistikave të FAO, në vitin 2018 prodhimi total i akuakulturës botërore arriti në 82.1 milionë tonë gjallesa ujore, me një vlerë totale të shitjes të “porta e aktivitetit = të prodhuesit” prej 250.1 miliardë dollarësh (FAO, 2020)

Prodhimi botëror i akuakulturës së gjallesave ujore të kultivuara u rrit mesatarisht me 5.3 për qind në vit në periudhën 2001–2018 (FAO, 2020). Kontributi i tij në prodhimin global të peshkut arriti 46 përqind në 2018, nga 25.7 përqind në 2000, ndërsa parashikohet të jetë 53 përqind deri më 2030 (FAO, 2020). Akuakultura i ka bërë peshqit dhe prodhimet e detit më të arritshme për konsumatorët në të gjithë botën, dhe duke qenë se është një mënyrë më efikase për të kthyer proteinat ushqyese në proteina ushqimore krahasuar me kostot e proteinave të tjera të ushqimit nga kafshët, akuakultura do të luajë një rol më të rëndësishëm në ushqimin e popullsisë globale që pritet të arrijë në 9 miliardë deri në vitin 2050 (Banka Botërore, 2013).



Prodhimi global i peshkut nga aktivitetet e akuakulturës dhe peshkimit (burimi: FAO, 2020)
Shënim. Përfshihen gjitarët, krokodilët, aligatorët dhe kajmanët, algat e detit dhe bimët e tjera ujore.

Ndërkohë që industria e akuakulturës vazhdon trendin e saj afatgjatë të rritjes pozitive, prodhimi global nga aktiviteti i peshkimit ka qenë relativisht i qëndrueshëm që nga fundi i viteve 1980, me prodhim vjetor që, në përgjithësi luhet mes 86 milionë tonë dhe 93 milionë tonë, megjithëse në vitin 2018 u arrit niveli më i lartë i regjistruar ndonjëherë, 96.4 milionë tonë (FAO, 2020).

Në vendet kufitare të Mesdheut dhe Detit të Zi, akuakultura ka pasqyruar trendin global të rritjes me rritjen e prodhimit nga 1,118,000 tonë në vitin 1998 (me vlerë 2,5 miliardë dollarë) në 3,030,000 tonë në vitin 2018 (me vlerë 6,8 miliardë dollarë). Më shumë se 100 lloje kultivohen në ujëra të ëmbla, ujëra të njelmët dhe mjedis detar duke gjeneruar më shumë se 500,000 vende pune direkte dhe indirekte.

Nga ana tjetër, në Mesdhe dhe në Detin e Zi prodhimi i peshkimit arriti vlerën e tij më të lartë prej rreth 1,800,000 tonë në mes të viteve tetëdhjetë, dhe që atëherë ka rënë nga një mesatare vjetore prej

1,473,429 tonë në vit për periudhën 2000–2013, në një mesatare prej 1,220,000 tonë në vit për periudhën 2014–2018. Akuakultura po bëhet gjithnjë e më shumë një aktivitet plotësues për aktivitetin e peshkimit në det, si një burim i qëndrueshëm i proteinave dhe një aktivitet kryesor për të garantuar sigurinë ushqimore.

ii. Zonat e përcaktuara për akuakulturën (ZPA) në Shqipëri

Akuakultura në Shqipëri, si kudo në botë, përfaqëson një sektor të rëndësishëm dhe zotëron një potencial të madh për komunitetet bregdetare. Për më tepër, ajo mund të sigurojë përfitime të shumta për sa i përket të ushqyerit të mirë, dhe të sjellë rezultate pozitive social-ekonomike. Prodhimi i përgjithshëm nga uji i ëmbël, uji i njelmët dhe mjedisi detar, është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të fundit nga 3,450 tonë në vitin 2012 në 6,258 tonë në vitin 2018 dhe ka një vlerë rreth 22 milionë USD (© FAO, 2011–2020).

Ligji nr. 103/2016¹ “Për akuakulturën” (Republika e Shqipërisë, 2016) ka për qëllim të kontribuojë në nxitjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së akuakulturës, nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë. Ligji përcakton bazën e nevojshme ligjore për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të prodhimit dhe kultivimit të organizmave ujorë në fushën e akuakulturës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji për akuakulturën synon të sigurojë një zhvillim më të qëndrueshëm të sektorit. Krijimi i ZPA-ve do të siguronte një integrim më të mirë të akuakulturës në zonat bregdetare dhe është një parakusht për dhënien e licencave dhe qirave të reja për akuakulturë. Këto të fundit janë thelbësore për të pasur një kornizë rregullatore dhe administrative kushtuar akuakulturës për të siguruar një zhvillim të shëndoshë dhe të qëndrueshëm të sektorit.

Pavarësisht nga rritja e prodhimit të akuakulturës gjatë viteve të fundit, bilanci tregtar neto për Shqipërinë mbetet në favor të importit. Shqipëria është një importuese neto e produkteve të peshkimit për të përmbushur kërkesën e brendshme. Në mënyrë të veçantë, dhe sipas statistikave të FAO, në dekadën 2009-2018 u tejkalua bilanci neto mesatar vjetor i produkteve të peshkimit – 6,200 tonë me një maksimum prej 8,276 tonë në vitin 2018 (© FAO, 2011–2020). Sipas statistikave të FAO, konsumi i dukshëm vjetor për frymë i peshkut dhe produkteve të peshkimit është ende i ulët në Shqipëri (8.6 kg) krahasuar me të gjithë Evropën (21.5 kg) në vitin 2017 (FAO, 2020b).

Prodhimi kombëtar i aktivitetit të peshkimit varion midis 7,800 dhe 8,600 tonë në vit (© FAO, 2011–2020) me një vlerë në hallkën e parë të shitjes prej rreth 23.56 milionë USD në vitin 2016 (FAO, 2018b). Sidoqoftë, ky prodhim nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar kërkesën kombëtare, dhe për pasojë Shqipëria importon produkte detare të akuakulturës, kryesisht kocë dhe levrek. Me rënien e nivelit të prodhimit vendas nga aktiviteti i peshkimit, zhvillimi i mëtejshëm i akuakulturës mbetet mënyra e vetme për të siguruar një prodhim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm të produkteve të peshkimit në Shqipëri.

Sa i takon marrëveshjeve ndërkombëtare, Shqipëria është një palë kontraktuese e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) të FAO-s dhe po zbaton rekomandimet e tij. Konkretisht për akuakulturën, në vitin 2017 GFCM ka miratuar “Strategjinë për zhvillimin e qëndrueshëm të Akuakulturës në Mesdhe dhe Detin e Zi (rezoluta GFCM/41/2017/1)”, e cila përcakton kornizën rajonale për zhvillimin e aktiviteteve të harmonizuara të akuakulturës dhe planeve të veprimit në rajon me synimin për të ndjekur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit. Strategjia e GFCM

¹ Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

Rregulloren (BE) nr. 1380/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2013, “Mbi politikën e përbashkët të peshkimit”, që amendon rregulloret e Këshillit (KE) nr.1954/2003 dhe (KE) nr.1224/2009 dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.2371/2002 dhe (KE) nr.639/2004 dhe vendimin e Këshillit 2004/585/KE, numri CELEX 32013R1380, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354, datë 28.12.2013, faqe 22– 61.

Rregulloren e Këshillit (KE) nr.199/2008, datë 25 shkurt 2008, “Mbi vendosjen e një kuadri të Komunitetit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit”, numri CELEX 32008R0199, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 60, datë 5.3.2008, faqe 1–12.

Rregulloren (BE) nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, lidhur me Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit, dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) nr.2328/2003, (KE) nr. 861/2006, (KE), nr. 1198/2006 dhe (KE) nr. 791/2007 dhe Rregulloren (BE) nr. 1255/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, numri CELEX 32014R0508, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 149, datë 20.5.2014, faqe 1–66.

vë theks të fortë në përmirësimin e drejtimit të akuakulturës dhe avokon për planifikimin e koordinuar hapësinor detar dhe zgjedhjen e zonave të përshtatshme për akuakulturë përmes krijimit të ZPA-ve. Strategjia e GFCM është paraprirë nga Rezoluta GFCM/36/2012/1 mbi udhëzimet për zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA), e cila (rezoluta) mbështet parimet e mirëqeverisjes (FAO, 2012).

Aktualisht, sektori i akuakulturës në Shqipëri gjeneron rreth 600 vende pune të drejtpërdrejta, duke përfshirë punën me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe të gjitha punësimet indirekte në aktivitetet ndihmëse ekonomike përgjatë zinxhirit të vlerës (p.sh. përpunimi, shpërndarja, shitja me pakicë, paketimi, pajisjet, industria e ushqimit, shërbimi ushqimor, turizmi etj.). Shqipëria ka një potencial të madh për të zhvilluar më tej sektorin duke pasur parasysh disponueshmërinë e zonave bregdetare në të cilat mund të zhvillohen aktivitetet e akuakulturës në ZPA-të për prodhimin e peshqve dhe të molusqeve. Një zgjerim i sektorit të akuakulturës do të gjeneronte punësim të mëtejshëm direkt dhe indirekt në të gjithë zinxhirin e vlerës, ndërsa në të njëjtën kohë do të kontribuonte në rritjen e marrjes së proteinave nga produktet e shëndetshme të peshkimit.

Bazuar në sa më sipër, ky dokument udhëzues i politikave propozon krijimin e ZPA-ve² bazuar në njohuritë më të mira shkencore dhe social-ekonomike të disponueshme, të siguruara, gjithashtu, nga institucionet përgjegjëse kombëtare.

iii. Masat dhe identifikimi i zonave për miratimin e zonave të përcaktuara për akuakulturë përgjatë bregdetit shqiptar

Ky dokument është një udhëzues i politikave për planifikimin e zonave të përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën” (Republika e Shqipërisë, 2016), më konkretisht, në përputhje me nenin 4 “Qëllimi dhe zbatimi i zonës së përcaktuar për akuakulturë (ZPA)”, nenin 5 “Përgatitja dhe miratimi i ZPA-së”, nenin 6 “Përmbajtja e ZPA-së” dhe nenin 7 “Monitorimi”. Ligji përcakton, gjithashtu, parimet themelore për zbatimin dhe menaxhimin e ZPA-ve në Shqipëri.

Ligji parashikon që ZPA-të: (i) miratohen nëpërmjet një sistemi planifikimi që synon integrimin e aktivitetit të akuakulturës në zonën ujore, bregdetare dhe tokësore me përdoruesit e tjerë, për të shmangur konfliktet në përdorimin e këtyre zonave; (ii) zbatohen për të lehtësuar dhe zhvilluar aktivitetin e akuakulturës në zonën ujore, bregdetare dhe tokësore, duke përfshirë procesin e lejimit dhe të procedurave të funksionimit; (iii) i shërbejnë përmirësimit të akuakulturës së qëndrueshme dhe kanë për qëllim koordinimin dhe integrimin e kompetencave e procedurave ndërmjet institucioneve të ndryshme publike, të përfshira në lejimin, kontraktimin dhe monitorimin e aktiviteteve të akuakulturës.

Në këtë dokument udhëzues të politikave përcaktohen rregulla të hollësishme për zbatimin e këtyre parimeve.

Dokumenti udhëzues i politikave është rezultat i punës së kryer në kuadër të projektit “Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri” (EuropeAid/155184/Act/AL) dhe posaçërisht nën Aktivitetin 1.10 – “Hartimi i planit mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) bazuar në udhëzimet dhe metodologjitë përkatëse”. Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me Ministrinë Shqiptare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) Aktivitetet u ndërmorën në bashkëpunim me Ministrinë Shqiptare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) brenda kuadrit të bashkëpunimit me Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM), dhe në bashkëpunim me Ministrinë Italiane të Politikave të Bujqësisë, Ushqimit dhe Pylltarisë (MIPAAF).

Dokumenti udhëzues i politikave është strukturuar në dy seksione. Seksioni i parë paraqet rezultatet e punës së kryer në drejtim të zonave të propozuara si ZPA përgjatë bregdetit shqiptar; kjo përfshin informacione mbi qëllimin kryesor, një fjalor të termave të përdorur, klasifikimin e ZPA-ve duke përfshirë një sërë masash për aplikimin e përafrimit proekosistemit në akuakulturë. Në fund, për secilën ZPA të identifikuar, jepen si në vijim: koordinatat gjeografike dhe hartat që tregojnë: (i) përdorimin aktual të tokës dhe aktivitetet bregdetare, si dhe duke evidentuar; (ii) kufijtë (poligonet) ZPA-ve të

² Ky dokument udhëzues i politikave për ZPA-të është në përputhje me:

- rezolutën GFCM/36/2012/1 miratuar në vitin 2012, e cila jep udhëzime për zbatimin e ZPA-ve dhe krijon kornizën themelore për të orientuar shtetet drejt miratimit të tyre (FAO, 2012);
- udhëzuesin teknik të GFCM mbi përcaktimin e ZPA-ve (Macias et al., 2019).
- Rezolutën GFCM/41/2017/2 mbi udhëzimet për modernizimin e proceseve të autorizimeve dhe qiradhënies për aktivitetet e akuakulturës (FAO, 2018a).

propozuara; dhe (iii) çdo aktivitet akuakulture që funksionon aktualisht në zonë. Rezultatet për akuakulturën e peshqve dhe molusqeve janë prezantuar dhe grupuar në katër zona kryesore bregdetare. I gjithë bregdeti shqiptar është analizuar mbi bazën e një rrjete kuadratike, ku çdo kuadrat shtrihet në 0.5 milje detare (nm).

Seksioni i dytë, përshkruan metodologjinë e aplikuar dhe informacion tjetër kryesor mbi të cilin është bërë përzgjedhja e ZPA-ve (për secilin parametër jepen vlerat që i atribuohen parametrat. Zona bregdetare shqiptare u nda në 7,559 njësi/kuadrate prej 0.5 milje detare², në të cilat të gjithë parametrat u shoqëruan në një format specifik për të zbatuar modelin për identifikimin e ZPA-ve. Në këtë drejtim, zonat për ZPA-të janë identifikuar bazuar në shkallën e pajtueshmërisë për akuakulturë sipas metodologjisë së aplikuar. Shkalla e pajtueshmërisë ka marrë parasysh parametrat mjedisorë dhe social-ekonomikë) përfshirë kriteret e përjashtimit dhe pajtueshmërisë (tabelat 47 dhe 48). Për secilin nga parametrat e identifikuar është paraqitur si vijon: diapazoni i marrë në konsideratë, faktori i peshimit dhe indeksi i aftësisë. Në fund, është dhënë një përmbledhje e shkurtër informuese e kuadrit të sektorit të akuakulturës në Shqipëri duke përfshirë një përmbledhje mbi kuadrin ligjor të akuakulturës (tabela 26), si dhe informacion mbi autoritetet kryesore dhe aktorët e tjerë të interesit (tabela 27).

1. SEKSIONI I

1.1 PJESA I

OBJEKTI, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Objekti dhe qëllimi

1. Ky dokument udhëzues i politikave do të propozojë miratimin e ZPA-ve përgjatë zonës bregdetare të Shqipërisë në përputhje me ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, dhe synon të identifikojë zonat e përcaktuara për akuakulturë, për një integrim më të mirë të akuakulturës me aktivitetet e tjera bregdetare dhe zhvillimin e potencialit të sektorit në Shqipëri.

2. ZPA-të janë zona të përcaktuara gjeografikisht, të kufizuara nga një poligon, në të cilat lejohen ose kufizohen të gjitha ose disa aktivitete të akuakulturës për të nxitur zhvillimin e akuakulturës në një zonë specifike.

3. Propozimi për ZPA-të është bërë duke marrë parasysh një sërë parametrash për të treguar përshtatshmërinë e tyre për akuakulturë, duke përfshirë: (i) mungesën e konflikteve me mënyra të tjera përdorimi të hapësirës detare; (ii) mungesën e ndërveprimeve negative me mjedisin ose habitatet e ndjeshme (p.sh.: livadhet e Posidonias) apo me zonat e mbrojtura detare; (iii) asnjë mbivendosje me rrugët e trafikut detar, zonat e peshkimit, zonat ushtarake apo aktivitete të tjera; (iv) mbrojtjen e zonave me vlera të trashëgimisë kulturore të gjetura në brendësi të kufijve detarë, në ujërat territoriale e të brendshme të Republikës së Shqipërisë; (v) prania e ndonjë aktiviteti tjetër të akuakulturës; (vi) mungesa e burimeve kryesore të ndotjes në afërsi të ZPA-së; (vii) thellësia e mjaftueshme e ujit që favorizon shpërndarjen e katabolitëve të prodhuar nga gjallesat ujore; (viii) substrati i përshtatshëm për ankorimin e strukturave të akuakulturës; dhe (ix) ekspozimi i ulët ndaj dallgëve dhe stuhive.

4. Sipas nenit 4 të ligjit, ZPA-të identifikohen nëpërmjet një sistemi planifikimi që synon integrimin e aktivitetit të akuakulturës në zonën ujore, bregdetare dhe tokësore me përdoruesit e tjerë, për të shmangur konfliktet në përdorimin e këtyre zonave.

5. Për qëllimet e mësipërme, u morr në konsideratë caktimi i ZPA-ve edhe sipas nenit 6 të ligjit nr. 103/2016, siç raportohet në pjesën V të këtij dokumenti, ndërkohë që zonat janë përcaktuar si më poshtë:

- Kategoria 01 e ZPA-ve – peshqit

6. Kategoria 01 e ZPA-ve – peshqit kufizohen nga vijat që bashkojnë koordinatat, të quajtura “poligonë” dhe të paraqitura në pjesën V të këtij dokumenti udhëzues të politikave.

7. Kategoritë e ZPA-ve u lokalizuan përgjatë bregdetit të Sarandës.

8. Masat për zbatimin e parimit të përafrimit të ekosistemit në akuakulturë, duke përfshirë edhe masat për ndjekjen e zhvillimit të qëndrueshëm të saj, janë sugjeruar në pjesën II të këtij dokumenti udhëzues të politikave.

9. ZPA-të identifikohen nga një akronim i përcaktuar nga një “kod alfanumerik” që përshkruan: vendndodhjen (zonën), numrin e ZPA-së në zonë; kategorinë (grupin e llojeve). Për peshqit është dhënë edhe sasia e vlerësuar e kapacitetit mbajtës të prodhimit.

Përkufizime

a) Zona e përcaktuar për akuakulturë (ZPA) në det: një zonë detare ku zhvillimi i akuakulturës ka përparësi mbi përdorimet e tjera, dhe për këtë arsye do t'i dedikohet kryesisht akuakulturës. Identifikimi i një ZPA-je do të rezultojë nga proceset e zonimit përmes planifikimit hapësinor me pjesëmarrje, përmes së cilës organet administrative përcaktojnë ligjërisht se cilat zona specifike hapësinore brenda një rajoni kanë prioritet për zhvillimin e akuakulturës. ZPA-ja përcaktohet bazuar në shkallën e pajtueshmërisë (SHP).

b) Zona e lejuar e efektit (ZLE): një zonë e shtratit të detit ose vëllimit të trupit ujor pritës në të cilin një autoritet kompetent lejon përdorimin e Standardeve specifike të cilësisë së mjedisit (SCM) për akuakulturën, pa kompromentuar në mënyrë të pakthyeshme shërbimet themelore mjedisore të siguruara nga ekosistemi.

c) Qiraja për akuakulturë: e drejta ekskluzive për të përdorur një zonë ujore ose tokë nën ujë, në pronësi të shtetit, për akuakulturë detare. Një qira për akuakulturë zakonisht jepet për një periudhë të caktuar kohore, në këmbim të një forme të caktuar pagese.

d) Licenca për akuakulturë: autorizimi për instalimin dhe funksionimin e një objekti akuakulture në ujë, që përshkruan aktivitetin që do të ndërmerret në këtë kuadër.

e) Shkalla e pajtueshmërisë (SHP): SHP përcaktohet duke marrë parasysh parametrat mjedisorë, socialë dhe ekonomikë që bazohen në njohuritë më të mira shkencore dhe teknike dhe në të dhënat e disponueshme, për ato zona në të cilat përcaktohet SHP-ja.

f) Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM): një grup aktivitetsesh të modeluara për të identifikuar dhe parashikuar ndikimet e një veprimi të propozuar mbi mjedisin biogeofizik dhe në shëndetin dhe mirëqenien e njeriut, si dhe për të interpretuar e komunikuar informacionin në lidhje me ndikimet dhe masat potenciale lehtësuese.

g) Programi i monitorimit të mjedisit (PMM) për akuakulturën detare të peshqve: një program monitorimi mjedisor për akuakulturën detare të peshqve modelohet si një mjet funksional fleksibël dhe i adaptueshëm, në dispozicion të autoriteteve dhe industrisë së akuakulturës, lidhur me praktikën e menaxhimit të akuakulturës, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së vetë sektorit.

h) Objektivat e cilësisë së mjedisit (OCM): objektivat e cilësisë së mjedisit janë kufijtë dhe tolerancat e dokumentuara në raportet dhe nivelet e matura të ndotësve të lejuar në ujë. E njohur si cilësia e ujit, një masë e testuar ujore duhet të jetë brenda një diapazoni të caktuar të tolerancës për t'u etiketuar si i përdorshëm për aktivitetet e parashikuara.

i) Standardi i cilësisë së mjedisit (SCM): standarti i cilësisë së mjedisit është një vlerë, e përcaktuar përgjithësisht me rregullore, e cila specifikon përqendrimin maksimal të lejueshëm të një kimikati potencialisht të rrezikshëm në një mostër mjedisorë, në përgjithësi të ajrit, ujit ose sedimenteve. Vlerat dhe parametrat e SCM-së vendosen nga autoritetet kompetente në një shtet.

j) Kriteret e përjashtimit (KP) dhe zona buferike (ZB): këto përshkruajnë zonat në të cilat nuk mund të zhvillohet akuakultura si për peshqit ashtu edhe për molusqet, ose përndryshe të zhvillohet duke zbatuar masat (kufizimi dhe distanca). KP dhe ZB zakonisht bazohen në zona dhe habitate, të mbrojtura zona ushtarake, zona arkeologjike, porte/infrastrukturë, zona turistike, zona peshkimi, shkarkime të ujërave të përdorur, kablllo dhe tubacione nënujore, korridoret e transportit detar, zona depozitimi të rërës për rigjenerimin e plazheve etj. dhe, në përgjithësi, ndërveprimet me aktivitete të tjera.

k) Akuakultura e peshkut në kosha: kultivimi apo rritja e peshqve nga personat fizikë ose juridikë, përmes përdorimit të teknologjisë së koshave të krijuar për të rritur prodhimin e peshqve përtej kapacitetit të tyre natyror në mjedis, duke ndërhyrë në ciklin e tyre të plotë ose të pjesshëm, në një zonë të zgjedhur dhe të kontrolluar të ujërave detare të Republikës së Shqipërisë.

l) Akuakulturë multitrofike e integruar (AMTI): është prodhimi i peshkut, parruazorëve (p.sh. bivalvorët) dhe bimëve (alga detare) në sistemet ujore dhe me një larmi metodash. AMTI ofron disa përfitime mjedisore, ekonomike dhe sociale dhe mund të ndihmojë në menaxhimin dhe drejtimin e aktiviteteve të akuakulturës në kuadër të përafrimit për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare (MIZB) dhe planifikimin hapësinor detar (PHD).

m) Poligon: paraqet kufirin e ZPA-së të përcaktuar nga vijat dhe koordinatat gjeografike.

n) Kapaciteti mbajtës i prodhimit: kapaciteti mbajtës i prodhimit është prodhimi maksimal i vlerësuar i akuakulturës që mund të mbështetet nga mjedisi duke shmangur në të njëjtën kohë çdo lloj ndikimi negativ në mjedis.

o) Qasja pro ekosistemit për akuakulturën (QEA): QEA është një strategji për integrimin e aktiviteteve të akuakulturës brenda ekosistemit për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë dhe larminë e sistemeve të ndërlidhura shoqërore, ekonomike dhe ekologjike.

p) Akuakultura e molusqeve: kultivimi apo rritja e molusqeve nga persona fizikë ose juridikë, përmes përdorimit të teknologjive të krijuara për të rritur prodhimin e tyre duke shfrytëzuar kapacitetin natyror të mjedisit, duke ndërhyrë në ciklin e tyre të plotë ose të pjesshëm, në një zonë të zgjedhur dhe të kontrolluar të ujërave detare të Republikës së Shqipërisë.

q) Pranueshmëria sociale e akuakulturës: pranueshmëria sociale është një pjesë integrale e qëndrueshmërisë dhe i referohet lejes sociale dhe shkallës në të cilën aktivitetet e akuakulturës pranohen nga komuniteti lokal, nga grupe të ndryshme të interesit dhe nga shoqëria në tërësi.

1.2 PJESA II

Menaxhimi dhe monitorimi i akuakulturës në ZPA

1. Zonat e klasifikuara si kategoria 01 e ZPA-ve – peshqit

- Çdo zonë e klasifikuar si kategoria 01 e ZPA-ve – peshqit, për të cilën identifikohet një kod identifikues unik (KIU) siç raportohet në pjesën V të këtij dokumenti udhëzues të politikave.

- Zonat janë të përshtatshme për aktivitetet e akuakulturës së peshqve, atje ku nuk ka mospërputhje me përdorime të tjera, dhe kushte të mira mjedisore.

- Çdo aktivitet i akuakulturës intensive të peshqve do të realizojë një VNM në përputhje me ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe shtesat dhe ndryshimet pasuese.

- Çdo autoritetet planifikuese shtetërore në nivel kombëtar, ndërvendor vendosin për miratimin, në të ardhmen, për çdo aktivitet të akuakulturës intensive të peshqve, duhet të jetë në përputhje me projektet e listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;

- Çdo autoritetet planifikuese shtetërore në nivel kombëtar, ndërvendor përpara fillimit të zbatimit të tyre, duhet të hartojnë një raport të “Vlerësimit strategjik mjedisor” për pasojat në mjedis, realizimin e konsultimeve me grupet e interesit, si dhe marrjen në konsideratë të rezultateve të raportit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

- Çdo aktivitet i akuakulturës së peshqve mund të lejohet në një zonë vetëm pasi të jepet licenca dhe qiraja nga autoritetet përkatëse.

- Çdo aktivitet i akuakulturës së peshqve në kosh (lundruet ose të zhytur), pa paragjykim, mund të lejohet në një zonë, dhe për të cilën është përcaktuar vlerësimi i kapacitetit të prodhimit.

- Çdo ZPA e përfshirë në Kategorinë 01 ka një kapacitet mbajtës të prodhimit në ton, i cili nuk mund të tejkalohet. Në çdo ZPA mund të ketë një ose më shumë aktivitete akuakulture.

- Çdo aktivitet akuakulture, për çdo zonë të dhënë me qira, duhet të zbatojë një sistem monitorimi mjedisor ante-operam, në funksionim e sipër dhe post-operam, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet që rregullojnë sektorin.

- Çdo aktivitet, në mënyrë që të përmirësojë gjendjen mjedisore, dhe ndërmerr aktivitete biolehtësuese, gjithashtu mund të lejohet të zbatojë aktivitetet e AMTI, pas miratimit të ministrisë.

- Çdo aktivitet që dëmton pasuritë kulturore detare dhe zonat me vlera të trashëgimisë kulturore është i ndaluar.

- Çdo aktivitet në këtë zonë duhet të bashkëpunojë me autoritetet kompetente në zbatimin e QEA siç përshkruhet në pjesën III.

2. Zonat e klasifikuara si kategoria 02 e ZPA-ve – molusqet

- Çdo zonë që do të klasifikohet si kategoria 02 e ZPA-ve – molusqet, për të cilën identifikohet një kod identifikues unik (KIU) siç raportohet në pjesën V të këtij dokumenti udhëzues të politikave.

- Çdo zonë që do të klasifikohet si kategoria 02 e ZPA-ve – molusqet, për të cilën identifikohet një kod identifikues unik (KIU) i qartë, siç raportohet në pjesën V të këtij dokumenti udhëzues të politikave

- Zonat janë të përshtatshme për aktivitetet e akuakulturës, atje ku nuk ka mospërputhje me përdorime të tjera, konflikte sociale, dhe kushte të mira mjedisore

- Çdo aktivitet i akuakulturës së molusqeve (në struktura gjatësore ose lundruese) në ZPA-të që do të identifikohen për akuakulturën e molusqeve, i nënshtrohet rregullave për klasifikimin e ujit bazuar në nivelin e ndotjes dhe monitorimin vijues sipas rregullave dhe udhëzimeve që rregullojnë sektorin (udhëzimi nr. 25, datë 25.11.2010 “Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”, kapitulli III – seksioni I) (transponon rregulloret e KE-së nr. 853/2004 e 854/2004).

- Çdo aktivitet i akuakulturës së molusqeve mund të lejohet në një zonë vetëm pasi të jepet licenca dhe qiraja nga autoritetet përkatëse.

- Çdo aktivitet akuakulture, për çdo zonë të dhënë me qira, duhet të zbatojë një sistem monitorimi mjedisor ante-operam, në funksionim e sipër dhe post-operam, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet që rregullojnë sektorin.

- Çdo aktivitet në këtë zonë duhet të bashkëpunojë me autoritetet kompetente në zbatimin e QEA siç përshkruhet në pjesën III.

1.3 PJESA III

Masat e parashikuara për ZPA-të

a) Masat për zbatimin e qasjes pro ekosistemit për akuakulturën (QEA)

Sipas nenit 6 të ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturë”, zbatimi i ZPA-ve do të kërkojë marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e qasjes pro ekosistemit për akuakulturën (QEA) për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të saj në lidhje me barazinë dhe elasticitetin e sistemeve të ndërlidhura shoqërore dhe ekologjike. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet pranueshmërisë shoqërore të akuakulturës, pa gjeneruar ndonjë konflikt me përdoruesit e tjerë të detit apo bregdetit.

Zbatimi i planeve të ZPA-ve duhet të integrohet brenda zhvillimit ekonomik lokal dhe prurjeve pozitive të akuakulturës në ekonominë lokale.

Sipas QEA, për çdo ZPA do të hartohen plane që do të përfshijë aktivitete dhe strategji komunikimi duke theksuar efektet pozitive të akuakulturës:

- Kur është e mundur, autoritetet apo institucionet, sipas rastit, dhe personat që merren me akuakulturë duhet të informojnë komunitetet lokale mbi kontributin në drejtim të mirëqenies social-ekonomike, duke theksuar mundësitë e punësimit dhe aktivitetet ekonomike të gjeneruara nga akuakultura përgjatë zinxhirit të vlerës (p.sh. përpunimi, shpërndarja, shitja me pakicë, paketimi, pajisjet, industria e ushqimit, shërbimi ushqimor, turizmi etj.), të gjeneruar nga aplikimi i ZPA-ve.

- Aktivitetet e peshkimit artizanal në hapësirat e ZPA-ve do të monitorohen sa i takon zënies së peshkut (sasia dhe vlera) për të nxjerrë në pah shërbimet e mundshme të ekosistemit që mund të sigurohen nga aktivitetet e akuakulturës duke rritur zënien e peshkut të egër në zonë.

- Kur është e mundur, autoritetet apo institucionet, sipas rastit, dhe personat që merren me akuakulturë duhet të informojnë komunitetet lokale dhe publikun e gjerë, mbi shërbimin pozitiv të ofruar në mjedis nga disa aktivitete të akuakulturës në ZPA siç është kultivimi i algave, molusqeve apo parruazorëve, sipas rregullores mbi acidifikimin nga sekuestrimi i karbonit.

- Autoritetet apo institucionet, sipas rastit, dhe personat që merren me akuakulturë duhet të informojnë komunitetet lokale dhe publikun e gjerë mbi statusin e cilësisë së mjedisit në të cilin kryhen aktivitetet e akuakulturës, si dhe mbi shëndetin e gjallesave në të.

- Aty ku është e mundur, autoritetet dhe personat që merren me akuakulturë do të bashkëpunojnë për të zbatuar modele biznesi që lidhin prodhimtarinë nga aktivitetet në ZPA me turizmin dhe edukimin (p.sh. vizita në vendin e aktivitetit, lejimi i peshkimit çlodhës në zonën pranë koshave etj.).

- Për sa më sipër, një sërë metodash do të ndiqen bashkërisht nga autoritetet lokale si: takime të përbashkëta, *workshop*-e, materiale të printuara, media, programe edukative etj. Aplikimi i metodave të pjesëmarrjes lokale në nivelin e ZPA-ve siç janë platformat me shumë aktorë interesi, mund të lehtësojë zbatimin e qasjes pro ekosistemit për akuakulturën.

b) Masat për zbatimin e sistemit të monitorimit të mjedisi për kategorinë 01 të ZPA-ve – peshqit

- Sipas nenit 6 të ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturë”, aktivitetet e akuakulturës duhet të kryejnë analiza mjedisore bazuar në standardet e cilësisë së mjedisit (SCM) dhe të mbajnë regjistra të kushteve mjedisore të zonës ku po zhvillohet aktiviteti, si dhe të zonës së ndikuar prej tij, që nga momenti i fillimit të instalimit, gjatë aktiviteteve të akuakulturës, apo gjatë mbylljes së aktivitetit.

- Për çdo ZPA të identifikuar, pa rënë ndesh me rregulloret ekzistuese në lidhje me monitorimin e ujit dhe monitorimin e produkteve të akuakulturës, duhet të merret parasysh sa vijon:

- Për çdo leje ushtrimi të aktivitetit të akuakulturës për peshqit, duhet të përcaktohet një zonë e lejuar e efektit (ZLE), në hapësirën përreth koshave, e cila normalisht përcaktohet nga zona e emetimit të dritës (ose pikat e sinjalizimit/fenerimit) dhe në çdo rast jo më pak se 50 metra nga koshi më i jashtëm.

- Brenda dhe jashtë ZLE, pa rënë ndesh me rregulloret ekzistuese, aktiviteti i akuakulturës duhet të shoqërohet nga një program monitorimi të mjedisit (PMM) kushtuar akuakulturës detare të peshkut.

- PMM duhet të jetë fleksibël dhe i adaptueshëm, duke marrë parasysh një përjasje të matshme (kohë dhe hapësirë), duhet të shpërndahet mes autoriteteve të ndryshme përgjegjëse për aktivitetet e akuakulturës, dhe monitorimi duhet të jetë i detyrueshëm.

c) Masat për monitorimin e ecurisë së aktiviteteve të akuakulturës

- Sipas nenit 7 të ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, monitorimi i ecurisë së aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës që kryhen në ZPA-të përgjatë zonës bregdetare bëhet në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, nga autoritetet përgjegjëse.

- Sapo të miratohet ZPA-ja, duhet të ketë një sistem treguesish për të monitoruar ecurinë e akuakulturës së qëndrueshme në nivelin e objekteve të akuakulturës, si dhe brenda hapësirave të ZPA-së.

- Treguesit duhet të përfshijnë aspektet mjedisore, ekonomike dhe sociale dhe mund të përfshijnë të paktën sa vijon:

Aspektet mjedisore

- Treguesi 1: vlerësimi i trendit të vlerës së SCM dhe pajtueshmërisë së vlerave të parametrave mjedisore në përputhje me ligjin, në nivelin e aktivitetit të akuakulturës në secilën ZPA dhe ZLE.

- Treguesi 2: ndjekja e ecurisë së zbatimit të planit të menaxhimit shëndetësor për peshqit dhe molusqet, në nivelin e aktivitetit të akuakulturës, që aplikohet për identifikimin, monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve dhe parazitëve.

- Treguesi 3: aktivitetet e akuakulturës brenda ZPA-ve me një sistem të aksesueshëm dhe të disponueshëm për regjistrimin e të dhënave, me qëllim monitorimin e parametrave mjedisore (përfshirë përdorimin e terapive, antibiotikëve dhe kimikateve).

Aspektet ekonomike

- Treguesi 1: trendi i sasisë dhe vlerës së prodhimit (ton) e konsideruar në lidhje me aktivitetet e planifikuara.

- Treguesi 2: kostoja për kg e prodhimit (p.sh.: krahu i punës, energjia, karburanti, ushqimi, rasatet, certifikimi) për të ndjekur përfitimin nga aktiviteti.

- Treguesi 3: brenda hapësirave të ZPA-ve, vlerësimi i ndërveprimit mes aktiviteteve të akuakulturës dhe prodhimit nga peshkimi artizanal (lidhur me sasinë dhe vlerën) në ZPA.

Aspektet sociale

- Treguesi 1: matja e zbatimit të një programi dhe iniciativave për të informuar komunitetet lokale dhe publikun mbi përfitimet nga akuakulturës në nivelin e ZPA-së.

- Treguesi 2: matja e ecurisë lidhur me promovimin, zhvillimin dhe zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit (PMM) në nivelin e aktivitetit të akuakulturës.

- Treguesi 3: numri i vendeve të punës, direkte dhe indirekte, të krijuara nga akuakultura në hapësirën e ZPA-së, duke marrë parasysh edhe zinxhirin e vlerës (p.sh. përpunimi, shpërndarja, shitja me pakicë, paketimi, pajisjet, industria e ushqimit, turizmi etj.).

1.4 PJESA IV

Duke zbatuar sistemin e treguesve, sipas rastit, autoritetet do të vlerësojnë rregullisht progresin e bërë në arritjet e objektivit të qëndrueshmërisë së ZPA-së. Si pasojë, dhe në përputhje me ndërveprimet mjedisore, ekonomike dhe sociale, ZPA-ja mund të rivlerësohet dhe, kur konsiderohet e nevojshme, të rishikohet dhe përditësohet lidhur me caktimin e kufijve dhe aplikimin e vetë ZPA-së.

Sipas nenit 5, paragrafi 4, të ligjit nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, është ngritur një sistem informimi mbi monitorimin, referuar hartave dhe GIS (sistemet informatike gjeografike), bazuar në aplikacionin për hartëzimin. Sistemi GIS bazuar në QGIS – një platformë ndërkëmbyese, e hapur dhe falas – mund të përdoret për të ndjekur ecurinë e zbatimit të ZPA-ve. Gjithashtu, mund të përfshijë

edhe një lidhje me sistemet e regjistrimit të të dhënave bazuar në standarde të përbashkëta dhe që mund të përdoren nga autoritete të ndryshme.

1.5 PJESA V

Kjo pjesë paraqet gjithë ZPA-të e identifikuar përgjatë zonës bregdetare të Shqipërisë, të cilat janë grupuar në katër nënzona të mëdha që janë: 1) Shëngjini, 2) Durrësi, 3) Vlora, dhe 4) Saranda.

Për secilën zonë bregdetare, janë marrë parasysh parametrat thelbësorë që lidhen me analizën hapësinore me shumë kriteret për përdorimin e tokës dhe aktivitetet bregdetare, si dhe parametrat fizike dhe mjedisore, si vijon: a) batimeria; b) lloji i shtratis të detit (p.sh. livadhet e Posidonias); c) zonat e mbrojtura detare; d) zonat e peshkimit artizanal; e) zonat e zhytjes; f) shkarkimet e ujërave të përdorura; g) zonat turistike; h) largësia nga porti më i afërt; i) grykëderdhjet e lumenjve; j) kanalet e lagunave; k) vija bregdetare; l) korridoret detare; m) tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit; n) dallgëzimi; o) shpejtësia e rrymave; p) temperatura e ujit në sipërfaqe; q) klorofili a.

Sa i takon përshtatshmërisë lidhur me identifikimin e ZPA-ve, parametrat e kriterëve të përjashtimit dhe vlerat e pajtueshmërisë, si dhe burimi i informacionit janë dhënë në seksionin II, që i referohet metodologjisë (tabela 47 dhe tabela 48). Në të njëjtin seksion është dhënë edhe informacion mbi faktorët e kushtëzimit, si dhe mbi kapacitetin e prodhimit për peshqit detarë.

Janë pjesë e ZPA të kategorisë 01 e gjithë zona mbi 3 (tre) milje detare duke mbajtur parasysh të gjitha kufizimet që rrjedhin nga rrugët detare ose përdorime të tjera.

Sipas metodologjisë së aplikuar, çdo ZPA shoqërohet me një kod identifikues unik (KIU) dhe veçoritë kryesore janë raportuar në tabela, si më poshtë:

Zona	Grupi	Kategoria e ZPA	Numri rendor	KIU	Sipërfaqja (km ²)	KMP
Emri i zonës (kodi 3 alfa)	Peshq (F) Molusqe(S)	01(peshk) 02 (mollusk)	Për zonën dhe grupin (numerik)	Numra dhe shkronja	(km ²)	(ton/vit)

Më poshtë është përshkruar ZPA-të e identifikuar përgjatë zonës bregdetare të Shqipërisë:

1.5.1 ZPA-të për zonën e Sarandës

1.5.1 ZPA-të për zonën bregdetare të Sarandës

Kjo zonë shtrihet përgjatë bregdetit shqiptar të Jonit në kepin e Qefalit, në pjesën e poshtme të tij.

Në këtë hapësirë u identifikua 1 ZPA për peshqit (fig. 1) me një shtrirje prej 5 km².

Për peshqit, kapaciteti mbajtës i prodhimit global vlerësohet në 2000 tonë në vit. Zona është e përshtatshme për akuakulturën e tonit (*Thunnus thynnus*).

Kategoria 01 e ZPA për peshqit

Tabela 1: Paraqitje e përgjithshme e hapësirës dhe kapaciteti mbajtës i prodhimit të ZPA për peshqit në zonën e Sarandës

Zona	Grupi	Kategoria e ZPA	Numri rendor	KIU	Sipërfaqja (km ²)	KMP (ton/vit)
Sarandë	Peshq	01	01	ZPA_SAR_F01_01	5	2000

Tabela 2: Koordinatat e ZPA_SAR_F01_01

	Gjerësia gjeografike	Gjatësia gjeografike
1	39°53'27.84"N	19°53'35.61"E
2	39°53'31.09"N	19°55'50.45"E
3	39°52'31.09"N	19°55'51.47"E
4	39°52'29.91"N	19°54'51.65"E
5	39°52'46.46"N	19°54'50.64"E
6	39°52'45.67"N	19°53'34.89"E




Figura 1: Identifikimi i kategorisë 01 të ZPA – peshqit në zonën e Sarandës

2. SEKSIONI II

2.1 Hyrje

Seksioni II paraqet informacionin bazë mbi të cilin është mbështetur përzgjedhja e ZPA-ve të sipërpërmendura në Shqipëri.

2.2 Akuakultura në Shqipëri

Akuakultura në Shqipëri i ka fillimet e saj rreth 50 vjet më parë, kur u ngrit ekonomia e parë ekstensive e krapit, për të garantuar që popullsia e zonës të kishte një furnizim të përbalueshëm të produkteve të peshkut. Aktualisht, ndërmarrjet shqiptare të akuakulturës përdorin teknika kultivimi intensive, gjysmë intensive dhe ekstensive. Llojet kryesore të kultivuara përfshijnë troftën (*Oncorhynchus mykiss* dhe *Salmo letnica*), levrekun (*Dicentrarchus labrax*), kocën (*Sparus aurata*) dhe midhjen (*Mytilus galloprovincialis*). Prodhimi i përgjithshëm i akuakulturës është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të fundit nga 3,450 tonë më 2012 në 6,258 tonë në 2018, vlera e të cilit ishte rreth 22 milionë USD (© FAO, 2011–2020). Kultura e koshave detare është pozicionuar në bregdetin e detit Jon, duke filluar nga gjiri i Vlorës deri në Sarandë (kepi i Stillos). Deri në vitin 2020 në gjirin e Vlorës ka pasur shtatë aktivitete akuakulture që kultivonin peshq në kosha, duke prodhuar të gjitha së bashku, rreth 75% të prodhimit kombëtar të kocës dhe levrekut; ndërsa në zonën e Sarandës kishte tetë aktivitete akuakulture, nga të cilat, pesë kultivonin kocën dhe levrekun dhe tre kultivonin midhjen.

Pavarësisht nga rritja e prodhimit gjatë viteve të fundit, bilanci tregtar neto për Shqipërinë mbetet negative. Shqipëria është importuese e produkteve të detit për të plotësuar kërkesën e brendshme për produktet e peshkut. Në mënyrë të veçantë, dhe sipas statistikave të FAO, në dekadën 2009-2018 u tejkalua bilanci neto mesatar vjetor i produkteve të peshkimit – 6,200 tonë me një maksimum prej 8,276 tonë në vitin 2018 (© FAO, 2011–2020). Prandaj, për të mbuluar kërkesën e brendshme, Shqipëria importon produkte detare të akuakulturës, kryesisht kocë dhe levrek nga Greqia. Me rënien e nivelit të prodhimit vendas nga aktiviteti i peshkimit, i cili ishte pak më shumë se 8,600 tonë në vit, zhvillimi i mëtejshëm i akuakulturës mbetet mënyra e vetme për të siguruar një prodhim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm të produkteve të peshkimit.

2.3 Kuadri ligjor për ZPA-të në Shqipëri

Shqipëria është një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian që nga qershori 2014 dhe, si e tillë, Shqipëria është në procesin e integritetit të legjislacionit të BE-së (*acquis*) në legjislacionin kombëtar (KE, 2020). Përparimi në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian varet nga arritjet që duhet të ketë Shqipëria në fushat kryesore. Në këtë kontekst, ligji i ri nr. 103/2016 “Për akuakulturën” është përafëruar pjesërisht me disa rregullore të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, mbi: politikën e përbashkët të peshkimit; vendosjen e një kuadri të Komunitetit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit; dhe Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit (Republika e Shqipërisë, 2016).

Sa i takon zhvillimit të mëtejshëm të akuakulturës detare, pas miratimit të ligjit për akuakulturën në vitin 2016, procesi i autorizimit (licencimit dhe dhënies me qira) të aktiviteteve të reja të akuakulturës do të lejohet vetëm kur plani për miratimin e zonave të përcaktuara për akuakulturë (ZPA) është përgatitur dhe aprovuar (KE, 2018; KE, 2019). Sa i takon marrëveshjeve ndërkombëtare, Shqipëria është një palë kontraktuese e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) të FAO-s dhe po zbaton rekomandimet e tij. Konkretisht për akuakulturën, në vitin 2017 GFCM ka miratuar “Strategjinë për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës në Mesdhe dhe Detin e Zi (rezoluta GFCM/41/2017/1)”, e cila përcakton kornizën rajonale për zhvillimin e aktiviteteve të harmonizuara të akuakulturës dhe planeve të veprimit në rajon me synimin për të ndjekur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit. Strategjia e GFCM vë theks të fortë në përmirësimin e drejtimit të akuakulturës dhe avokon për planifikimin e koordinuar hapësinor detar dhe zgjedhjen e zonave të përshtatshme për akuakulturë përmes krijimit të ZPA-ve. Strategjia e GFCM është paraprirë nga rezoluta GFCM/36/2012/1 mbi udhëzimet për zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA), e cila (rezoluta) mbështet parimet e mirëqeverisjes (FAO, 2012).

ZPA-ja përkufizohet si “një zonë detare ku zhvillimi i akuakulturës ka përparësi mbi përdorimet e tjera, dhe për këtë arsye do t’i dedikohet kryesisht akuakulturës. Identifikimi i një ZPA-je do të rezultojë nga proceset e zonimit përmes planifikimit hapësinor me pjesëmarrje, përmes së cilës organet administrative përcaktojnë ligjërisht se cilat zona specifike hapësinore brenda një rajoni kanë prioritet për zhvillimin e akuakulturës” (Sánchez-Jeréz et al., 2016). Në rajonin e Mesdheut, roli i ZPA-ve si një mjet planifikimi vlerësohet se siguron një kornizë të përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës në zona të dedikuara. Krijimi i ZPA-ve kontribuon në integrimin e duhur të akuakulturës brenda planifikimit hapësinor detar dhe zonave bregdetare, gjë që është thelbësore për parandalimin e konflikteve mbi përdorimin e hapësirës detare

ZPA-ja përfshin ndër të tjera, bashkëpunimin për shkëmbimin e njohurive, konsensusin e shumë palëve të interesuara dhe integrimin e aspekteve mjedisore dhe sociale, duke kontribuar kështu në ngritjen e sistemeve elastike të ndërlidhura shoqërore dhe ekologjike për një zgjerim të qëndrueshëm të sektorit. ZPA-ja kërkon një program fleksibël dhe të adaptueshëm të Monitorimit të Mjedisit (PMM) për të siguruar që janë respektuar standardet e cilësisë së mjedisit (SCM) për kolonën e ujit dhe shtratën e detit.

Për më tepër, miratimi i zonës së lejuar të efektit (ZLE) pranë aktiviteteve të akuakulturës do të siguronte dimensionin hapësinor të mbrojtjes së mjedisit. Zonat e lejuara të efekteve janë zonat e shtratit të detit ose vëllimit të trupit ujqor pritës në të cilat autoriteti kompetent mund të lejojë përdorimin e SCM-ve specifike për akuakulturë, pa kompromentuar në mënyrë të pakthyeshme shërbimet themelore mjedisore të siguruar nga ekosistemi (Sánchez-Jeréz dhe Karakassis, 2011; Massa, Onofri dhe Fezzardi, 2017), (shih gjithashtu përkufizimin te pjesa I).

2.4 Kuadri ligjor për akuakulturën në Shqipëri

Kuadri ligjor themelor për sektorin e akuakulturës në Shqipëri sigurohet kryesisht nga ligji nr. 103/2016 “Për akuakulturën”. Dispozitat e këtij ligji kontribuojnë në promovimin dhe zhvillimin e akuakulturës në vend, ndërsa në të njëjtën kohë sigurojnë një përdorim të qëndrueshëm të burimeve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në përgjithësi, ligji përfshin kapitujt në vijim (baza e të dhënave FAOLEX; Republika e Shqipërisë, 2016): 1) Dispozitat e përgjithshme; 2) Miratimi i zonave të përcaktuara për akuakulturë; 3) Veprimtaria e akuakulturës; 4) Ushtrimi i veprimtarisë së akuakulturës; 5) Ndikimi mjedisor; 6) Grumbullimi i të

dhënave; 7) Autoritetet vendimmarrëse dhe organet konsultative; 8) Politika strukturore; 9) Kërkesa të përgjithshme dhe detyrime; 10) Sanksionet; 11) Dispozita përfundimtare.

Më konkretisht, në lidhje me objektivin e përpjekjeve për miratimin dhe menaxhimin e ZPA-ve, duhet të theksohen dispozitat e mëposhtme (tabela 26):

Tabela 3: Dispozitat kyç në ligjin për akuakulturën, që lidhen me miratimin dhe menaxhimin e ZPA-ve

Neni	Përmbajtja
Neni 2	Parashikohet se ky ligj përcakton bazën e nevojshme ligjore për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të prodhimit dhe kultivimit të organizmave ujorë në fushën e akuakulturës në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Neni 3 Paragrafi 7	Përkufizon ZPA-në si një sistem planifikimi hapësinor apo zonimi, i kryer në nivel kombëtar; ZPA-ja ka për qëllim të identifikojë një zonë të përcaktuar për akuakulturë, të njohur nga autoritetet e planifikimit hapësinor, që konsiderohet si prioritet për zhvillimin e akuakulturës
Neni 4	Përvijon qëllimin dhe zbatimin e ZPA-ve përfshirë integrimin më të mirë të aktivitetit të akuakulturës me aktivitete të tjera bregdetare dhe përmirësimin e koordinimit mes autoriteteve përkatëse.
Neni 5	Përvijon procesin e identifikimit dhe përgatitjes së ZPA-ve duke përfshirë ministrinë përgjegjëse, si dhe procesin e miratimit të ZPA-ve nga Këshilli i Ministrave
Neni 6	Përcakton përshtatshmërinë e zonave për aktivitet akuakulture, bazuar në tri kategori zonimi: a) zona të përshtatshme për aktivitetin e akuakulturës; b) zona të papërshtatshme për aktivitetin e akuakulturës; c) zona për aktivitet të akuakulturës me rregulla të veçanta dhe/ose kufizime.
Neni 8	Përcakton procedurat për marrjen e zonave tokësore ose ujore përmes konkurrimit publike sipas Rregullores nr. 2, datë 10.12.2014. Detyron aktivitetin e akuakulturës për t'u pajisur me licencën me kodin II.3.B, siç parashikohet në Vendimin nr. 538 datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe neneve 15 dhe 36 të ligjit nr. 10081/2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" Parashikon se Drejtoria dhe Inspektorati i Peshkimit, dhe institucione të tjera vlerësojnë plotësimin e kushteve të licencimit sipas kodit II.3.B.
Neni 34	Nisur nga qëllimi për respektimin e kushteve mjedisore, deklaron se çdo subjekt që zotëron të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton përmbushjen e kushteve mjedisore lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis, të zonës ku zhvillon aktivitetin dhe të zonës që ndikohet prej tij, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Në përputhje me legjislacionin aktual, ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", paragrafi a) i nenit 8 "Projektet që i nënshtrohen VNM-së paraprake".
Neni 36 Neni 37	Nenet parashikojnë se personat juridikë ose fizikë, që ushtrojnë aktivitetin e akuakulturës, janë të detyruar të grumbullojnë dhe dorëzojnë në drejtori të dhëna të sakta për aktivitetin, në përputhje me nenin 93, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

Megjithëse ligji për akuakulturën përcakton kuadrin kryesor ligjor për kultivimin dhe prodhimin e organizmave ujorë dhe akuakulturës në Republikën e Shqipërisë, vetë ligji për akuakulturë dhe sektori i akuakulturës në përgjithësi i referohet ligjeve dhe rregulloreve të tjera, që ndikojnë, ndër të tjera, proceset për ngritjen e objekteve të akuakulturës, vlerësimin e ndikimit në mjedis, licencimin dhe dhënien me qira të akuakulturës, monitorimin e akuakulturës dhe detyrimin për zbatimin e rregullave.

2.5 Autoritetet kryesore përgjegjëse për akuakulturën dhe aktorët e tjerë kyç

Sipas ligjit nr. 103/2016 "Për akuakulturën" (neni 38), autoritetet vendimmarrëse për çështjet e akuakulturës janë të njëjta me ato të përcaktuara në ligjin nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe ato kanë të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi. Në këtë dokument udhëzues të politikave, janë identifikuar aktorët kryesorë të interesit të angazhuar në akuakulturë, si dhe kompetencat e tyre (tabela 27).

Tabela 4: Autoritetet kryesore përgjegjëse për akuakulturën dhe aktorët e tjerë kyç

Aktorët e interesit	Kompetencat në lidhje me akuakulturën	Referenca ligjore
Ministritë/Autoritetet kombëtare		

Aktorët e interesit	Kompetencat në lidhje me akuakulturën	Referenca ligjore
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Ministria është përgjegjëse për rregulloret që lidhen me mjedisin, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, promovimin e burimeve të rinovueshme, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, dhe monitorimin e cilësisë së burimeve ujore. Ajo është përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM). Gjithashtu, është përgjegjëse për kuadrin ligjor lidhur me menaxhimin e zonave të mbrojtura (ZM); dhe standardet; mbikëqyr menaxhimin e ZM-ve.	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”. http://turizmi.gov.al/
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Ministria është përgjegjëse për bujqësinë, zhvillimin rural, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, peshkimin dhe akuakulturën duke përfshirë dhënien e licencave për aktivitete të akuakulturës, dhe administrimin e ujërave. Gjithashtu është përgjegjëse për statistikën kombëtare për peshkimin.	Zëvendësoi Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në vitin 2017 Ligji nr. 64/2012 rregullon veprimtarinë e peshkimit në tërësi, menaxhimin e tij, siguron mbrojtjen e gjallesave detare dhe të ujërave të brendshme, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm në aktivitetin në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme. https://bujqesia.gov.al
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Kryen gjithë funksionet që kishte Ministria e Transportit deri në vitin 2017. Përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe shërbimeve postare, në sektorin e energjisë, përdorimin e burimeve energjetike dhe minierave dhe sektorin e industrisë.	Përfshin Ministrinë e Transportit, pas bashkimit në vitin 2017 https://www.infrastruktura.gov.al/
Ministria e Kulturës	Ministria ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit, administrimit dhe promovimit të pasurive kulturore. Gjithashtu është përgjegjëse për kuadrin ligjor lidhur me menaxhimin e zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore.	Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”; VKM nr. 208, datë 10.4.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”; VKM nr. 279, datë 2.5.2019 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore”; http://kultura.gov.al/

Aktorët e interesit	Kompetencat në lidhje me akuakulturën	Referenca ligjore
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK)	IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale. IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, harton kriteret e hulumtimeve arkeologjike, shqyrton dokumentacionin teknik në lidhje me to, si dhe kryen mbikëqyrjen e proceseve arkeologjike dhe ecurisë së projekteve zhvillimore, në varësi të vendimeve të organeve vendimmarrëse kolegjiale.	Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”; VKM nr. 364, datë 29.5.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” http://iktk.gov.al/site
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	Agjencia ka përgjegjësi dhe detyra mbi menaxhimin e sektorit të ujit. Ajo planifikon, ekzekuton, kontrollon punën dhe garanton që produktet apo shërbimet janë të duhurat, në kohë, brenda buxhetit, në sasinë dhe cilësinë e kërkuar. Analizon progresin, vlerëson devijimet në raport me objektivat, standardet dhe planin e menaxhimit, si dhe menaxhon ndryshimet e nevojshme në program e në burime. Harton dhe ndjek zbatimin e të gjitha planeve të menaxhimit të kërkuara nga ligji, nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore, në bashkëpunim me strukturat shtetërore përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, si dhe aktorët e tjerë. Menaxhon dhe koordinon procesin e programimit, zbatimit dhe monitorimit të nismave/projekteve/programeve të administrimit të burimeve ujore në bashkëpunim me ministrinë e linjës, institucionet qendrore e vendore, donatorë dhe partnerë të tjerë zhvillimorë.	Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar Vendim nr. 221, datë 26.4.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së menaxhimit të burimeve ujore” http://www.ambu.gov.al/
Ministria e Mbrojtjes	Përfshin Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) që siguron mbikëqyrjen e hapësirës detare shqiptare. QNOD koordinon dhe drejton ndër të tjera, operacionet për të mbrojtur peshkimin; operacionet për të ruajtur ekuilibrin ekologjik dhe mjedisin detar; dhe operacionet për mbrojtjen dhe administrimin e mirë të burimeve të peshkimit.	https://www.mod.gov.al/
Këshilli i Ministrave	Është organi ekzekutiv që përbën Qeverinë e Shqipërisë. Lidhur me akuakulturën, Këshilli i Ministrave është përgjegjës për miratimin e ZPA-ve të identifikuar dhe për të gjitha procedurat që lidhen me caktimin e një personi juridik për të ndërmarrë aktivitetet e akuakulturës.	Ligji nr. 103/2016 Për Akuakulturën https://www.kryeministria.al/

Aktorët e interesit	Kompetencat në lidhje me akuakulturën	Referenca ligjore
Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturë (nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural)	Përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit, porteve dhe qendrave të peshkimit; mbledh të dhëna për peshkimin; harton programe për ripopullimin me peshq; menaxhon qendrën dhe impiantet e midhjeve në Sarandë; menaxhon ekonominë e peshkimit në Zvezdë, Korçë, ekonominë e koranit në Lin, Pogradec dhe ekonomitë e tjera të peshkut. Garanton pajtueshmërinë me kërkesat ligjore në fushën e mbrojtjes së peshkimit dhe akuakulturës përmes monitorimit dhe inspektimit të aktiviteteve të peshkimit.	VKM nr. 719, datë 20.10.201, ndryshuar me VKM nr. 1068, datë 14.12.2013, më pas amenduar me VKM nr. 44, datë 29.1.2014 dhe me urdhër nr. 96, datë 21.2.2014
Agjencia Kombëtare e Mjedisit (nën Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit)	Agjencia është e përkushtuar për të përmirësuar, ruajtur dhe promovuar mjedisin e vendit dhe ushtron veprimtarinë për një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor përmes një menaxhimi të shëndoshë dhe efektiv të burimeve. Është përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM).	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”. http://www.akm.gov.al
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (nën Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit)	Menaxhimi, mbrojtja, zhvillimi, zgjerimi dhe funksionimi i zonave të mbrojtura në vend duke përfshirë zonat e mbrojtura detare (ZMD-të)	Krijuar në shkurt të vitit 2015 nga qeveria e Republikës së Shqipërisë http://akzm.gov.al/
Agjencia Kombëtare e Bregdetit (nën Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit)	Mbrojtja dhe zhvillimi i një ambienti të qëndrueshëm të zonës bregdetare, përmes monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare dhe detare dhe aseteve mjedisore të përfshira në të, si dhe kontrolli i veprimtarive turistike në të gjithë territorin.	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 31 datë 22.01.2014 http://www.bregdeti.gov.al/
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë)	Koordinon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, të cilat janë ndërmarrë nga autoritetet e planifikimit në nivelin qendror dhe lokal duke siguruar që ato të jenë në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; siguron ndihmë teknike për autoritetet përgjegjëse për planifikimin hapësinor.	Ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 9, si dhe VKM nr. 427, datë 08.06.2016 http://www.planifikimi.gov.al/
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural)	Instituti është përgjegjëse për marrjen rregullisht të mostrave të midhjeve në impiantet e midhjeve dhe ujërat përreth për analiza mikrobiologjike. Rezultatet e testeve përdoren më pas nga Ministria e Bujqësisë për të klasifikuar ujin në bazë të nivelit të ndotjes, d.m.th. klasa A, B ose C.	http://www.isuv.gov.al/

Aktorët e interesit	Kompetencat në lidhje me akuakulturën	Referenca ligjore
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural)	Autoriteti është përgjegjës për garantimin e sigurisë ushqimore në vend, në mënyrë që vetëm produktet që janë të sigurta për konsum njerëzor të dalin në treg. Për akuakulturën e molusqeve, siguron që të gjithë molusqet që shiten në treg kanë certifikimet e nevojshme (të origjinës, depurimit).	https://aku.gov.al/
Institucione rajonale		
Agjencitë Rajonale të Mjedisit	Bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e rregulloreve lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM).	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. VKM nr. 686, datë 29.7.2015 Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore.
Këshillat e Baseneve Ujore Zyrat e Administrimit të Basenit Ujor	Këshilli i basenit ujor është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës në nivel vendor dhe se një nga detyrat e tij është të sigurojë shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujor, sipas qëllimeve të përdorimit. Këshilli i basenit ujor lëshon autorizimet dhe lejet në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe brenda kufijve të një baseni të vetëm. KBU lëshon lejet për dhënien në përdorim të burimeve ujore për zhvillimin e akuakulturës. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor është struktura në varësi të AMBU-së, e cila ngrihet dhe funksionon në çdo basen ujor dhe ndërmjet të tjerave ka si detyrë ndjekjen dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe Këshillit të Basenit Ujor.	Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” http://ambu.gov.al/

2.6 Metodologjia për përzgjedhjen e ZPA-ve

Procesi i identifikimit të ZPA-ve është realizuar duke integruar metodologjitë e ndryshme që aplikohen aktualisht në Mesdhe, si dhe bazuar në disponueshmërinë e të dhënave në Shqipëri dhe mundësinë e aksesimit të tyre. Jepet informacion edhe mbi përafrimin e ndjekur për përcaktimin e kriterëve të përjashtimit, zonave buferike, si dhe mbi parametrat dhe diapazonin e përdorur për llogaritjen e Shkallës së Pajtushmërisë për ZPA-të. Këto të fundit, kur është e përshtatshme, përqendrohen veçmas në akuakulturën e peshqve dhe atë të molusqeve. Gjithashtu, jepet informacion edhe mbi burimin e të dhënave të grumbulluara.

Interesi përgjatë bregdetit shqiptar për një zonë të caktuar për zhvillimin e akuakulturës është bazuar në shkallën e përputhshmërisë (SHP) për zhvillimin e këtij aktiviteti. SHP ka mundësuar që të përcaktohen zona të caktuara brendahapësirës së studimit, me qëllim evidentimin e përshtatshmërisë së tyre për zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës.

Parametrat e analizuar, indeksi i përshtatshmërisë (SI) dhe faktori i peshimit (K) i aplikuar për çdo parametër të marrë në konsideratë është bazuar në kontekstin social-ekonomik dhe në specifikat e zonave të marra në konsideratë. Përzgjedhja e këtyre zonave është bërë duke marrë parasysh një sërë parametrash për të evidentuar përshtatshmërinë e tyre për akuakulturë, të cilat përfshijnë mungesën e konflikteve me përdorime të tjera të hapësirës detare, mungesën e burimeve kryesore të ndotjes në

afërsi, thellësinë e mjaftueshme, substratin e përshtatshëm për ankorimin e objekteve të akuakulturës dhe praninë e strukturave mbrojtëse nga stuhitë.

Zona bregdetare shqiptare u nda në 7,559 njësi/kuadrate prej 0.5 milje detare², në të cilat të gjithë parametrat u shoqëruan në një format specifik për të zbatuar modelin për identifikimin e ZPA-ve.

Bazuar në informacionin e disponueshëm, për çdo kuadrat u analizuan informacionet e mëposhtme:

- a) përdorimet e tokës, aktivitetet bregdetare dhe parametrat e disponueshëm fizikë dhe mjedisorë;
- b) Kriteret e Përrjashtimit (KP) dhe zonat buferike (ZB), c) Shkalla e përputhshmërisë dhe kapaciteti mbajtës i prodhimit.




Figura 2: Ndarja e bregdetit shqiptar në njësi kuadrate prej 0.5 milje detare

2.6.1 Vlerësimi i shkallës së pajtueshmërisë

Identifikimi i ZPA-ve rezulton nga proceset e zonimit brenda konceptit të planifikimit hapësinor, i cili plotëson të gjitha parakushtet për zhvillimin e akuakulturës pa shkaktuar presion mbi mjedisin dhe, në të njëjtën kohë, duke u pranuar me vullnet të lirë nga të gjithë përdoruesit e hapësirës detare. Shkalla e pajtueshmërisë (SHP) për aktivitetet e akuakulturës është vlerësuar pas integritit të informacionit të grumbulluar dhe prodhimit të hartave përshkruese. Modeli i aplikuar për të përcaktuar indeksin e përshtatshmërisë dhe faktorët e peshimit të secilit parametër ishte ai i përshkruar nga Del Castillo y Rey dhe Macías (2006) dhe i përshtatur nga Fourdain (2017) dhe i përshtatur më tej edhe për molusqet nga Niță et al. (2020) Përveç kësaj, janë bërë modifikime të mëtejshme të kriterëve për të pasur një qasje specifike për brigjet shqiptare.

Në mënyrë specifike, SHP është llogaritur sipas formulës së mëposhtme:

$$SHP = 100 \times \frac{\sum_i^n K_i \times SI_i}{\sum_i^n K_i}$$

Ku:

SHP = Shkalla e pajtueshmërisë.

K_i = Faktori i peshimit, i aplikuar për secilin parametër të marrë në konsideratë.

SI_i = Indeksi i përshtatshmërisë i aplikuar në zonë në përputhje me ndikimin e mundshëm prej secilit parametër

i = Parametri

n = Numri i parametrave

Vlera e shkallës së pajtueshmërisë mund të variojë nga -10000 në 100; janë përcaktuar tri kategoritë e mëposhtme të pajtueshmërisë (tabela 5):

Tabela 5: Vlerësimi përfundimtar sipas llogaritjes së shkallës së pajtueshmërisë (SHP)

Vlera	Vlerësimi përfundimtar
-10000 < DC < -30	Zonë e papajtueshme
-30 ≤ DC ≤ 30	Zonë e pajtueshme në mënyrë të moderuar
30 < DC < 100	Zonë e pajtueshme

Në këtë vlerësim, janë hartëzuar vetëm zonat e pajtueshme (me SHP që varion nga 30 në 100). Zonat e papajtueshme korrespondojnë me zonat ku është aplikuar kriteri i përjashtimit dhe duhet të analizohen dhe hulumtohen më tej për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme dhe të krahasueshme.

2.6.2 Faktori i peshimit (K_i)

K_i mund të ketë vlera që variojnë nga 1 në 10, në përputhje me rëndësinë e secilit parametër dhe ndikimin e tij në sektorin e akuakulturës. Për secilin parametër të marrë në konsideratë në këtë studim janë përcaktuar vlera të ndryshme. Ky faktor luhet sipas rëndësisë së parametrit lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës. Përveç kësaj, vlera varet nga besueshmëria e të dhënave dhe informacionit, si dhe sipas specifikave të zonës. Sa më e lartë të jetë vlera, aq më e madhe është rëndësia dhe besueshmëria e parametrit.

2.6.3 Indeksi i përshtatshmërisë (SI_i)

Parametrat që lidhen me punën e kryer përgjatë bregdetit shqiptar janë klasifikuar sipas diapazoneve ose kategorive (të paktën dy), në të cilat vlerat eaktuara ndryshojnë si më poshtë:

- 100: Kjo vlerë përfaqëson një zonë që konsiderohet e përjashtuar për shkak të ndikimit negativ të aktivitetit në mjedis (p.sh. prania e livadheve të Posidonias) apo të mjedisit brenda vetë aktivitetit (p.sh. lulëzimet e algave të dëmshme, vendet e ndotura, shkarkimet e ujërave të përdorura). Gjithashtu, papajtueshmëria mes aktivitetëve të ndryshme detare dhe përdorimeve të tjera (p.sh. korridoret detare, zonat e mbrojtura detare [ZMD] dhe zonat ushtarake) nënkupton se këto zona konsiderohen si zona të përjashtuara. Në këto raste janë aplikuar kriteret e përjashtimit.

- 1: Zonë e papërshtatshme për zhvillimin e duhur të akuakulturës. Sidoqoftë, këto zona përfshijnë karakteristika që lejojnë kushte të kufizuara për kultivim, por mbeten zona shumë të papërshtatshme për të aplikuar zhvillimin e akuakulturës si për peshqit, ashtu dhe për molusqet.

- 0: Zonë me përshtatshmëri të moderuar. Përdorimi i këtyre zonave rekomandohet nëse merren masa për të zvogëluar kufizimet dhe që mund të menaxhohen.

- 1: Zonë e përshtatshme. Në këtë diapazon shfaqen të gjitha karakteristikat optimale për një zhvillim të qëndrueshëm të akuakulturës.

2.6.4 Skenari dhe parametrat e marrë në konsideratë

Skenari për ZPA-të e identifikuar ka marrë në konsideratë një sërë kushtesh të vlerësuara si thelbësore për analizën hapësinore me shumë kritere, si dhe duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- a) batimetria;
- b) lloji i shtratis të detit;
- c) zonat e mbrojtura detare;
- d) zonat e peshkimit artizanal;
- e) zonat e zhytjes;
- f) shkarkimet e ujërave të përdorur;
- g) zonat turistike;
- h) largësia nga porti më i afërt;
- i) deltat e lumenjve;
- j) kanalet e lagunave;
- k) vija bregdetare;
- l) korridoret detare;
- m) tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit;
- n) dallgëzimi;
- o) shpejtësia e rrymave;
- p) temperatura e ujit në sipërfaqe;
- q) klorofili a.

Batimetria

Thellësia e përshtatshme për të pozicionuar objektet e akuakulturës së peshkut varion nga 30 deri në 80 metra (tabela 6). Këto thellësi mund të kontribuojnë në zbutjen e ndikimeve të mundshme që lidhen me aktivitetin e akuakulturës, të tilla si grumbullimi i mbetjeve në shtratin e detit, dhe mund të parandalojnë humbjet financiare që shkaktohen nga dëmtimet e rrjetave.

Zonat me thellësi të barabartë ose më pak se 30 metra do të ishin të papërshtatshme nga pikëpamja teknike, ekonomike dhe mjedisore. Rekomandohet që të lihet një distancë të paktën 15 m nga baza e objektit deri në shtratin e detit (FAO, 2015).

Thellësitë 30–50 m konsiderohen si opsioni më i mirë për sa i përket efektshmërisë së kostos, megjithëse çdo thellësimi 30 m është e preferueshme duke marrë parasysh që në këto thellësi është më e lehtë shpërndarja e lëndëve ushqyese dhe jashtëqitjeve. Thellësitë 50–80 m nuk janë ekonomikisht të përshtatshme dhe përtej këtyre thellësive, ato fillojnë të jenë gjithnjë e më pak të pranueshme, me përjashtim kur ka një platformë (p.sh. objektet për shfrytëzimin e energjisë së erës në det të hapur).

Thellësia më e ulët për akuakulturën e molusqeve konsiderohet 8 m, duke marrë parasysh edhe shërbimin ekologjik të ofruar nga kjo veprimtari në drejtim të sekuestrimit të karbonit dhe largimit të tepricave të lëndëve ushqyese (tabela 6).

Tabela 6: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për batimetrinë (SIbathy) dhe faktori i tij i peshimit (Kbathy)

Parametri	Vlera për peshqit		Kbathy
Batimetria	< 30 m	SIbathy = -100	9
	30 - 50 m	SIbathy = 1	
	50 - 80 m	SIbathy = 0	
	80 - 125 m	SIbathy = -1	

Parametër	Vlera për molusqet	Kbathy
Batimetria	<5; >100 m	SIbathy = -100
	10 - 30 m	SIbathy = 1
	8 - <10; >30 - 40 m	SIbathy = 0
	5 - <8; >40 - 100 m	SIbathy = -1

Burimi i informacionit për batimetrinë

Harta batimetrike e bregdetit shqiptar u përgatit duke përdorur aplikacionin Map Source Garmin. Koordinatat e pikave të thellësisë për të gjithë zonën e studimit janë marrë/dixhitalizuar nga ky aplikacion në mënyrë që të krijohen shtresat batimetrike duke përdorur GIS. Batimetria për gjirin e Vlorës u hartua duke përdorur të dhëna për thellësinë e ujit, të cilat janë dixhitalizuar nga një hartë detare në shkallën 1:35,000 të siguruar nga Instituti Gjeografik Ushtarak në Shqipëri (2002).

Lloji i shtratit të detit

Shtrati ranor dhe lymor është më i përshtatshmi për vendosjen e koshave në det, pasi sigurohet ankorim i mirë. Substratet e përziera konsiderohen më pak të përshtatshme (FAO, 2015).

Livadhet e Posidonia oceanica janë zona rreptësisht të paprekshme. Ky lloj shtrati, së bashku me livadhet e fanerogamëve të tjerë, klasifikohen si zona veçanërisht sensitive dhe mjaft të ndjeshme ndaj proceseve të degradimit (tabela 7). Holmer et al. (2008) rekomandon një zonë buferike prej 400 m për mbrojtjen e Posidonia oceanica, si distancë për zhvillimin e aktiviteteve të akuakulturës së peshkut, me qëllim shmangien e efekteve të padëshirueshme që shkatojnë nga këto aktivitete.

Tabela7: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për llojin e shtratit të detit (SIbt) dhe faktori i tij i peshimit (Kbt)

Parametri	Vlera për peshqit	Kb t
Lloji i shtratit të detit	Livadhet e Posidonia oceanica dhe zona të tjera të ndjeshme, psh. koraligjenët	SIbt = -100
	Livadhet e Posidonia oceanica (≤ 400 m)	SIbt = -100
	Shtrat ranor dhe lymor	SIbt = 1
	Substrat i përzier	SIbt = 0

Parametri	Vlera për molusqet	Kbt
Lloji i shtratit të detit	Livadhet e Posidonia oceanica dhe zona të tjera të ndjeshme, psh. koraligjenët	SIbt = -100
	Livadhet e Posidonia oceanica (≤ 100 m)	SIbt = -100
	Ranor	SIbt = 1
	Substrat i përzier	SIbt = 0
	Shkëmbor, argjilor, lymor	SIbt = -1

Burimi i informacionit për llojin e shtratit të detit

Livadhet e Posidonias dhe shkëmbinjtë koralorë u përcaktuan bazuar në “planin strategjik për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare”, të përgatitur nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe zhvilluar me mbështetjen e UNDP-së në kuadrin e Projektit “Përmirësimi i Mbulimit dhe Efikasitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare”(INCA, 2013).

Shtretërit ranorë dhe lymorë si dhe substratet e përziera, nuk u klasifikuan për të gjithë zonën për shkak të mungesës së të dhënave. Disa informacione mbi komunitetet bentike u mbledhën në kontekstin e aktiviteteve kërkimore. Në këtë drejtim, zonat përtej livadheve të Posidonias u konsideruan si substrate të përziera.

Zonat e mbrojtura detare

Në lidhje me zonat e veçanta të mbrojtura siç janë ZMD-të, indeksi i përshtatshmërisë u caktua sipas kategorive të IUCN-së³ (Tabela 8) dhe duke marrë parasysh shembujt e ndërveprimeve mes aktiviteteve të akuakulturës dhe ZMD-ve, siç raportohet nga Le Gouvello et al. (2017) Sidoqoftë, në pak raste,

³<https://www.iucn.org/news/marine-and-polar/201703/aquaculture-and-marine-protected-areas-report>.

aktivitetet e qëndrueshme të akuakulturës mund të kryhen në ZMD, për shembull kultivimi i Molusqeve që luan një rol në sekuestrimin e CO₂ dhe biorehabilitimin; ose akuakultura për ripopullim me qëllim ruajtjen e biodiversitetit – megjithatë, këto nuk janë marrë parasysh në këtë studim.

Tabela 8: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për zonat e mbrojtura detare (SIMPA) dhe faktori i tij i peshimit (KMPA)

Parametri		Vlera	KMPA
Zonat e mbrojtura detare	Shtirja e ZMD-së (kategoria II)	SIMPA= -100	7
	Zona e influencës (≤ 1 km)	SIMPA= 0	
	Jashtë ZMD-së	SIMPA= 1	

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet.

Burimi i informacionit për zonat e mbrojtura detare

Janë marrë në konsideratë hapësirat brenda zonës së mbrojtur detare dhe parqeve kombëtare sipas kategorive të IUCN-së dhe siç paraqiten në tabelën 9.

Zonat administrohen nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit përmes Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri (AKZM). Në veçanti, Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan (Gjiri i Vlorës) dhe Parku Kombëtar i Butrintit (në zonën e Sarandës), u konsideruan si rreptësisht të paprekshëm dhe të papajtuësëm me aktivitetet e akuakulturës intensive të peshqve. Për më tepër, u morën në konsideratë edhe zonat detare dhe bregdetare të propozuara për zona të mbrojtura, siç sugjerohet në dokumentet e UNEP/MAP-RAC/SPA⁴ dhe IUCN⁵.

Tabela 9: Zona e mbrojtur detare dhe parqet kombëtare në Shqipëri sipas kategorizimit të IUCN (Burimi: Kashta, 2010)

Kategoria e IUCN	Emri i zonës	Viti i shpalljes
II	Parku Kombëtar Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966
II	Parku Kombëtar Butrint	VKM nr. 693, datë 10.11.2005
II	Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta	VKM nr. 687, datë 19.10.2007
II	Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan	VKM nr. 289, datë 28.4.2010
IV	Rezervat natyror i menaxhuar Kune-Vain-Tale	VKM nr. 432, datë 28.4.2010
IV	Rezervat natyror i menaxhuar Karaburun	Rregullore e Ministrisë së Bujqësisë nr. 1, datë 27.7.1977
IV	Rezervat natyror i menaxhuar Patok-Fushë Kuqe-Ishëm	VKM nr. 995, datë 3.11.2010
IV	Rezervat natyror i menaxhuar Rrushkull	Rregullore e Ministrisë së Bujqësisë nr. 2, datë 26.12.1995
V	Peizazh i Mbrojtur Vjose-Nartë	VKM nr. 680, datë 22.10.2004
V	Peizazh i Mbrojtur Lumi i Bunës-Velipojë	VKM nr. 682, datë 2.11.2005

Zonat e peshkimit artizanal

Në Mesdhe janë regjistruar disa ndërveprime mes akuakulturës në kosha dhe burimeve të peshkimit, disa prej të cilave raportojnë një rritje të popullatave fundore (demersale). Peshkatarët artizanalë të zonës lejohen të peshkojnë përreth koshave, falë një marrëveshje joformale me akuakultoret në gjirin e Vlorës dhe me disa në zonën e Sarandës. Në Gjirin e Vlorës është i ndaluar peshkimi (fundor dhe pelagjik) (kufizohet në veri nga linja prej nga Kepit të Gjuhëzës-Karaburun deri në Treport). Në përgjithësi, ndalohet përdorimi i mjeteve të peshkimit me tërheqje në largësi më pak se 3 milje detare nga bregu ose deri 50 metra thellësi. Përveç kësaj, aktivitetet e peshkimit janë të ndaluara në zonat e mëposhtme: në zonën me rreze 2 km nga grykëderdhja e lumit të Bunës dhe 1 km nga grykëderdhjet e të gjithë lumenjve të tjerë të vendit, si dhe në zonën bregdetare të përfshirë brenda harkut me rreze prej 2 km me qendër në vendin e derdhjes së kanaleve të lagunave në det.

⁴ www.rac-spa.org IUCN-Med.

⁵ https://www.iucn.org/sites/dev/files/content/documents/2016/en_rac_spa_adriatic_albania1.pdf.

Sipas informacionit të grumbulluar dhe nivelit të të dhënave, në këtë studim janë marrë në konsideratë dy kategorizime për të përcaktuar indeksin e përshtatshmërisë së zonave të peshkimit artizanal (tabela 10):

Tabela 10: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për zonat e peshkimit artizanal (SIfish) dhe faktori i tij i peshimit (Kfish)

Parametri		Vlera	Kfish
Zonat e peshkimit artizanal	Zonat e peshkimit artizanal për aktivitetet e reja	SIfish = -1	5
	Zonat e peshkimit artizanal për aktivitetet ekzistuese	SIfish = 1	
	Jashtë zonave të peshkimit	SIfish = 1	

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet

Burimi i informacionit për zonat e peshkimit artizanal

Informacioni mbi aktivitetin dhe zonat e peshkimit artizanal u mor nga raporti i censurit dhe analizës së aktivitetit të peshkimit në shkallë të vogël (artizanal) (2019). Raporti dhe aktivitetet përkatëse u paraqitën nga OJQ-ja shqiptare Hydra dhe u mundësuan me mbështetjen e projektit “Asistencë Institucionale për Zhvillimin e Ekonomisë Detare dhe Bregdetare në Shqipëri – MARE”, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe Qendra Ndërkombëtare e Studimeve të Avancuara Agronomike Mesdhetare në Bari, Itali (CIHEAM / IAMB) në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar Italian të Kërkimit (CNR) dhe financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS).

Zonat e zhytjes

Objektet e akuakulturës mund të jenë një vend tërheqës për organizimin e aktiviteteve të zhytjes siç po ndodh tashmë në disa vende. Për më tepër, aktivitetet edukative për jetën detare dhe mjedisin përreth mund të kombinohen me aktivitete zhytjeje me maskë dhe me bombola përreth koshave dhe/ose impianteve të midhjeve (akuaturizmi) (tabela 11).

Tabela 11: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për zonat e zhytjes (SIDive) dhe faktori i tij i peshimit (KDive)

Parametri		Vlera	KDive
Zonat e zhytjes	Në zonat e zhytjes dhe rreth tyre (≤ 500 m)	SIDive= 1	6 (na)

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet

Burimi i informacionit për zonat e zhytjes

Janë marrë në konsideratë zonat kryesore të zhytjes dhe që janë të disponueshme në internet.

Shkarkimet e ujërave të përdorur

Pikat e shkarkimit të pozicionuara përgjatë vijës bregdetare, të cilat shkarkojnë në një thellësi të caktuar mund të kenë një efekt negativ, si në zhvillimin e aktiviteteve prodhuese ashtu dhe në mjedis. Objektet e akuakulturës duhet të pozicionohen duke marrë parasysh këto shkarkime përgjatë bregdetit, në mënyrë që cilësia e ujit të shkarkuar të mos ndikojë në cilësinë e prodhimit. Ky parametër mund të shkaktojë ndikime ekonomike negative dhe afatgjata në aktivitetet e akuakulturës (Macias et al., 2019) (tabela 12).

Tabela 12: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për shkarkimet e ujërave të përdorur (SIww) dhe faktori i tij i peshimit (Kww)

Parametri		Vlera	Kww
Shkarkimet e ujërave të përdorur	Shpërndarja e ndotësve ndikon tek aktiviteti (≤ 2 km)	SIww= -100	5
	Më shumë se 2 km larg pikës së shkarkimit	SIww= 1	

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet.

Burimi i informacionit për shkarkimet e ujërave të përdorur

Të dhënat për shkarkimet e ujërave të përdorur u morën nga “Raporti i Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri”⁶. Ky raport vjetor përgatitet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Pozicionet e stacioneve të kampionimit për të monitoruar parametrat fiziko-kimikë për zonën bregdetare u përcaktuan nga “Harta e stacioneve të monitorimit në detet Adriatik dhe Jon, viti 2018” të raportit të mjedisit.

Zonat turistike

Zonat me interes turistik janë pjesë e elementëve administrativë të analizuar në këtë studim. Akuakultura mund të ndikojë negativisht në sektorin e turizmit, për shkak të ndikimit të saj negativ vizual. Sidoqoftë, në disa zona, ekziston ndërveprimi pozitiv kur organizohen aktivitetet e turizmit të akuakulturës (p.sh. vizita në objektet e akuakulturës).

Në këtë studim, është krijuar një bazë e të dhënave gjeografike, në të cilën, plazhet turistike dhe zonat e hoteleve janë konsideruar si zona turistike përgjatë bregdetit. Për më tepër, në zonat ku turizmi ka një intensitet të lartë (si në Vlorë), një zonë buferike deri në 2 km larg bregdetit është përcaktuar si zonë e papërshtatshme për akuakulturë. Për më tepër, një zonë tjetër buferike 2–4 km është konsideruar si e përshtatshme në mënyrë të moderuar, aty ku turizmi është shumë i zhvilluar.

Ndërkohë, për zonat ku turizmi përgjatë bregdetit është më pak intensiv (siç është rasti i Sarandës), zhvillimi i akuakulturës në hapësirat brenda zonës buferike prej 2 km janë konsideruar si zona të pranueshme për shkak të: (i) klasifikimit si aktivitete të vogla që prodhojnë më pak se 250 tonë në vit (Barazi-Yeroulanos, 2010), dhe (ii) janë aktivitete që kontribuojnë në ekonominë lokale, pasi furnizojnë restorantet në zonë dhe shitësit me pakicë (tabela 13).

Tabela13: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për zonat turistike (SI_{tour}) dhe faktori i tij i peshimit (K_{tour})

Parametri	Vlera për peshqit		K _{tour}
Zonat turistike	< 2 km	SI _{tour} = -1	4
		SI _{tour} = 0 për aktivitete të vogla	
	2-4 Km	SI _{tour} = 0	
	> 4 km	SI _{tour} = 1	

Parametri	Vlera për molusqet		K _{tour}
Zonat turistike	< 2 km	SI _{tour} = 0	4
	> 2 km	SI _{tour} = 1	

Burimi i informacionit për zonat turistike

Zonat kryesore të zhvillimit urban dhe turistik janë përcaktuar bazuar në “Planin strategjik për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare” të përgatitur nga INCA (2013).

Largësia nga porti më i afërt

Largësia mes koshave të akuakulturës dhe portit më të afërt është një element thelbësor që duhet marrë parasysh. Ky element duhet vlerësuar për shkak të ndikimit të tij ekonomik dhe financiar në aktivitetet e akuakulturës. Në këtë studim, largësia maksimale e përshtatshme për të ngritur një objekt akuakulture është vlerësuar 10 milje detare. Më shumë se 10 milje detare mund të sjellë humbje financiare që lidhen me kostot e karburantit (tabela 14).

Tabela14: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për largësinë nga porti më i afërt (SI_{port}) dhe faktori i tij i peshimit (K_{port})

Parametri	Vlera		K _{port}
Largësia nga porti më i afërt	≤ 0.54 milje detare	SI _{port} = -100	5
	≥ 10 milje detare	SI _{port} = 0	
	0.54 - 10 milje detare	SI _{port} = 1	

⁶http://www.akm.gov.al/cil%c3%absia-e-mjedisit.html#raporte_publicime

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet.

Burimi i informacionit për largësinë nga porti më i afërt

Vendndodhjet e porteve në Shqipëri janë nxjerrë nga baza e të dhënave e Komitetit Drejtues Ndërkombëtar për Hartëzimin Global. Më pas, u vlerësua largësia nga porti më i afërt dhe pastaj, me anë të softuerit QGIS u krijuan tri zona buferike përmes programit “Fixed distance buffer”.

Grykëderdhjet e lumenjve

Grykëderdhja e një lumi është shpesh e rëndësishme në aspektin mjedisor të faunës së saj dhe për karakteristikat hidrologjike dhe ekologjike. Ajo është një habitat i rëndësishëm ku, ndër të tjera, edhe falë rrymave dhe reotropizmit dhe në veçanti pranisë së llojeve eurihaline, peshqit tërhiqen në këtë zonë ose për riprodhim, ose për t’u ushqyer dhe, si në rastin e lagunave bregdetare, është një korridor i rëndësishëm i migrimit dhe i biodiversitetit (tabela 15).

Tabela 15: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për grykëderdhjet e lumenjve (SIRimo) dhe faktori i tij i peshimit (KRimo)

Parametri	Vlera	KRimo
Grykëderdhjet e lumenjve	≤ 2km nga Lumi i Bunës	SIRimo= -100
	≤ 1 kmnga lumenjtë e tjerë të Shqipërisë	SIRimo=-100
	> 2 km nga Lumi i Bunës	SIRimo= 1
	> 1 kmnga lumenjtë e tjerë të Shqipërisë	SIRimo= 1

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet.

Burimi i informacionit për grykëderdhjet e lumenjve

Kufizimi i aplikuar për peshkimin në grykëderdhjet e lumenjve, aplikohet edhe për akuakulturën. Në mënyrë specifike, vlerat janë përcaktuar sipas nenit 43/2 të rregullores nr. 1 (Republika e Shqipërisë, 2005) “Për zbatimin e legjislacionit për peshkimin dhe akuakulturën” dhe i referohen zonave buferike me rreze 2 km nga grykëderdhja e lumit të Bunës dhe rreze 1 km nga grykëderdhjet e lumenjve të tjerë të Shqipërisë, ku peshkimi është i ndaluar. Ky ndalim aplikohet edhe në pjesën e jashtme të Karaburunit (deri në 1 nm ose deri në 50 m thellësi).

Kanalet e lagunave

Peshkimi dhe forma të ndryshme të akuakulturës janë kryer në lagunat mesdhetare që nga kohërat antike. Duke marrë parasysh tiparet ekologjike dhe brishtësinë e ekosistemeve lagunore, është i nevojshëm hartimi i planeve të duhura të menaxhimit, për të siguruar ruajtjen e biodiversitetit dhe mjediseve përkatëse (Cataudella et al., 2015). Mbrojtja e kanaleve të lagunave është thelbësore veçanërisht për sa i përket ruajtjes së biodiversitetit, lejimit të migrimit të llojeve të ndryshme në laguna dhe garantimin e shkëmbimeve. Duhet të garantohej edhe shkëmbimi i ujit mes detit dhe lagunave. Duhet të ndalohet zbatimi i aktiviteteve të akuakulturës intensive të peshqve në kanalet e laguna, ndërkohë që ndalim nuk duhet të merret parasysh për akuakulturën e Molusqeve duke pasur parasysh aftësinë e tyre për të larguar tepricën e lëndëve ushqyese nga mjedisi (tabela 16).

Tabela 16: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për kanalet e lagunave (SILag) dhe faktori i tij i peshimit (KLag)

Parametri	Vlera për peshqit	KLag
Kanalet e lagunave	≤ 2 km	SILag = -100
	> 2 km	SILag= 1

Burimi i informacionit për kanalet e lagunave

Kufizimi i aplikuar për peshkimin në një zonë buferike me rreze 2 km nga gryka e kanaleve të komunikimit të lagunave me detin, bazohet në Rregulloren nr. 1 (Republika e Shqipërisë, 2005) për zbatimin e legjislacionit për peshkimin dhe akuakulturën.

Vija bregdetare

Vija bregdetare është një nga zonat më produktive nga këndvështrimi ekologjik, në Tokë. Ajo përbën një pjesë të zonës bregdetare ku ka një përqendrim të lartë të aktiviteteve njerëzore dhe siguron habitatin për shumë lloje. Çdo aktivitet i akuakulturës për peshqit duhet të pozicionohet në një largësi të përshtatshme nga vija bregdetare, në përputhje me ligjin dhe rregulloret (tabela 17).

Tabela17: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për vijën bregdetare (SISho) dhe faktori i tij i peshimit (KSho)

Parametri		Vlera për peshqit	KSho
Vija bregdetare	≤300 m	SISho= -100	5
	>300 m	SISho = 1	

Burimi i informacionit për vijën bregdetare

Kufizimi i aplikuar për peshkimin në një zonë buferike prej 300 m nga kufiri i vijës bregdetare është ai që përcakton rregullorja nr. 8 (Republika e Shqipërisë, 2009c), neni 12/3 “Është i ndaluar përdorimi i koshilokëve në largësi më të vogël se 300 metra nga vija bregdetare...”. Disa distanca kërkohen nga Ministria dhe zbatohen kur jepet një leje zhvillimi për aktivitetin e akuakulturës së peshqve.

Korridoret detare

Aktivitetet e akuakulturës, si për peshqit dhe për molusqet, duhet të pozicionohen në zona që nuk ndërhyjnë në korridoret detare. Përderisa këto korridore, në mënyrë strikte, janë pranë ose brenda porteve, ka një shkallë më të lartë tolerance në det të hapur ku mjetet lundruese mund të ndjekin një korridor më të gjerë sipas vendimit të kapitenit (tabela 18).

Tabela 18: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për korridoret detare (SIMaro) faktori i tij i peshimit (KMaro)

Parametri		Vlera	KMaro
Korridoret detare	≤ 200 m	SIMaro= -100	5
	>200 m	SIMaro = 1	

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet.

Burimi i informacionit për korridoret detare

Të dhënat dhe informacioni lidhur me korridoret detare janë marrë nga Rrjeti Evropian i Vëzhgimit dhe të Dhënave Detare (EMODnet)⁷ - Portalet e të Dhënave – Aktiviteti i Njeriut.

Tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit

Aktivitetet e akuakulturës, si të peshqve ashtu dhe të Molusqeve, ndërveprojnë me kolonën e ujit, si dhe me shtratin e detit, ku shtrihen tubacionet dhe kabllot e telekomunikimit. Gjithashtu, mirëmbajtja periodike e objekteve të akuakulturës kërkon mbajtjen e një distance të përshtatshme nga struktura të tilla (d.m.th. > 500 m) për të shmangur ndonjë dëmtim eventual (tabela 19).

Tabela 19: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë për tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit (SIPipe) dhe faktori i tij i peshimit (KPipe)

Parametri		Vlera	KPipe
Tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit	≤ 500 m	SIPipe = -100	5
	>500 m	SIPipe = 1	

Të njëjtat vlera aplikohen për peshqit dhe molusqet.

Burimi i informacionit për tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit

Të dhënat dhe informacioni lidhur me tubacionet në det dhe kabllot telekomunikimit janë marrë nga Rrjeti Evropian i Vëzhgimit dhe të Dhënave Detare (EMODnet) – Portalet e të Dhënave – Aktiviteti i Njeriut.

Dallgëzimi

Dallgët janë valë mekanike të gjeneruara nga ndryshimet e motit dhe që shpesh kanë një gjatësi vale të gjatë. Dallgëzimi luan një rol të rëndësishëm në aspektet hidrodinamike dhe strukturore të

⁷ <https://emodnet.eu/en>.

akuakulturës së peshqve në kosha lundrues. Dallgëzimi ekstrem i shkaktuar nga stuhitë mund të shkaktojë dëme në unazën lundruese, rrjetën, sistemin e ankorimit dhe pjesët e tjera mekanike të objekteve të akuakulturës (tabela 20).

Tabela 20: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë së dallgëzimit (SISwe) dhe faktori i tij i peshimit (KSwe)

Parametri	Vlera për peshqit		KSwe
Dallgëzim mesatar	> 3 m	SISwe = -1	4
	< 1 m	SISwe = 0	
	1 - 3 m	SISwe = 1	
Dallgëzim ekstrem (stuhi)	> 6 m	SISwe = -1	4
	3-6 m	SISwe = 0	
	< 3 m	SISwe = 1	

Parametri	Vlera për molusqet		KSwe
Dallgëzim mesatar	> 3 m	SISwe = -1	4
	< 1 m	SISwe = 0	
	1 - 3 m	SISwe = 1	
Dallgëzim ekstrem (stuhi)	> 6.4 m	SISwe = -1	4
	3-6.4 m	SISwe = 0	
	< 3 m	SISwe = 1	

Burimi i informacionit për dallgëzimin

Të dhënat dhe informacioni mbi dallgëzimin u morën nga komponenti hapësinor “Sentinel” i Shërbimit të Monitorimit të Mjedisit Detar Copernicus, në formatin NetCDF. U përdor baza e të dhënave orare për detin Mesdhe, në një rezolucion hapësinor prej rreth 4 km² për periudhën nga viti 2010 deri më 2020, prodhuar në kuadër të projektit CMEMS duke zbatuar një model të bashkuar të valës hidrodinamike, të zbatuar në detin Mesdhe dhe bazuar në modelin e valës WAM Cycle 4.5.4.

Shpejtësia e rrymave

Shpejtësia aktuale është një parametër me rëndësi të madhe në planifikimin hapësinor detar për akuakulturën me kosha në det. Kjo ndikon në kapacitetin e shpërndarjes së mbetjeve ushqimore dhe jashtëqitjeve të peshkut të kultivuar dhe kështu ka ndikim potencial në komunitetin bentik dhe mjedisin rrethues. Diapazoni më i përshtatshëm i shpejtësisë aktuale është midis 15 dhe 60 cm/s. Nga ana tjetër, sa i takon kultivimit të molusqeve, shpejtësia e rrymave lidhet drejtpërdrejt me aftësinë për të mbajtur një furnizim të mjaftueshëm me grimca ushqimore në pezulli dhe me oksigjen. Kështu, diapazoni optimal për molusqet do të ishte midis 3 dhe 10 cm/s. Detajet janë dhënë në tabelën 21.

Tabela 21: Përcaktimi i indeksit të përshtatshmërisë së shpejtësisë së rrymave (SISpcu) dhe faktori i tij i peshimit (KSpcu)

Parametri	Vlera për peshqit		KSpcu
Shpejtësia e rrymave	≤ 5 cm/s; ≥ 60 cm/s	SISpcu = -1	8
	5 - 15 cm/s	SISpcu = 0	
	15 - 60 cm/s	SISpcu = 1	
Parametri	Vlera për molusqet		KSpcu
Shpejtësia e rrymave	> 50 cm/s	SISpcu = -1	6
	2 - <3; >10 - 5 cm/s	SISpcu = 0	
	3-10 cm/s	SISpcu = 1	

Burimi i informacionit për shpejtësinë e rrymave

Të dhënat e shpejtësisë mesatare ditore në formatin NetCDF u siguruan nga projekti evropian CMEMS EU, prodhuar me anë të modelit NEMO ocean versioni 3.1 në një rrjet të rregullt me rezolucion hapësinor prej 6 km. Të dhënat e shpejtësisë aktuale drejt lindjes (u) dhe veriut (v) (m s-1) u shkarkuan për periudhën nga viti 2010 deri më 2020.

Temperatura e ujit në sipërfaqe

Temperatura e ujit në sipërfaqe (TUS) mund të përdoret si një tregues i temperaturës së detit, e cila është një variabël kyç që ndikon, ndër të tjera: (i) aktivitetin metabolik të peshqve dhe molusqeve (raste ekstreme); (ii) praninë dhe cikline jetës së parazitëve dhe patogjenëve; (iii) vulnerabilitetin e peshqve dhe molusqeve ndaj patogjenëve; dhe (iv) prodhimtarinë primare dhe lulëzimet e algave, duke përfshirë edhe lulëzimet e algave të dëmshme (LAD). Tabela 22 paraqet detajet për peshqit dhe molusqet.

Tabela 22: Përcaktimi i indeksit të temperaturës së ujit në sipërfaqe (SISst) dhe faktori i tij i peshimit (KSst)

Parametri		Vlera për peshqit	KSst
Temperatura e ujit në sipërfaqe (°C)	≤11; ≥ 30	SISst = -1	5
	11-<18; >26-≤30	SISst = 0	
	18-26	SISst = 1	

Parametri		Vlera për molusqet	KSst
Temperatura e ujit në sipërfaqe (°C)	<5; >29	SISst = -1	5
	5 - <10; >20 - 29	SISst = 0	
	10 - 20	SISst = 1	

Burimi i informacionit për temperaturën e ujit në sipërfaqe

Të dhënat dhe informacioni mbi TUS a janë marrë nga programi Copernicus⁸, i cili mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe synon zhvillimin e shërbimeve evropiane të informacionit bazuar në Satelitin e Vëzhgimit të Tokës dhe të dhëna në vend (jo-hapësinore). Konkretisht, u konsultua Shërbimi i Monitorimit të Mjedisit Detar Copernicus (CMEMS) i cili përdor satelitë “Sentinel” për pjesën hapësinore dhe të dhënat u siguruan në formatin NetCDF. U përzgjedh një bazë e të dhënave për TUS me rezolucion hapësinor 1 km², nga viti 2010 deri më 2020.

Klorofili a

Klorofili a është një tregues i densitetit të fitoplanktonit, i cili është një variabël kyç që ndikon: (i) të gjithë rrjetën ushqimore pelagjike, e cila bazohet në produktivitetin e fitoplanktonit; (ii) rritjen e Molusqeve, pasi fitoplanktoni është burimi kryesor i energjisë; (iii) statusin trofik dhe dinamikën e oksigjenit të tretur, veçanërisht në zonat e pasuruara me azot (N) dhe fosfor (P). Disponueshmëria e ushqimit shpesh lidhet me dinamikën e fitoplanktonit, ndaj aktiviteti i akuakulturës së Molusqeve duhet të zhvillohet në zona me përqendrim të lartë të fitoplanktonit (tabela 23).

Tabela 23: Përcaktimi i indeksit të klorofilit a (SICHlo) dhe faktori i tij i peshimit (KChlo)

Parametri		Vlera për molusqet	KChlo
Klorofili a (µg/l)	< 0.5	SICHlo = -1	9
	> 0.5	SICHlo = 1	

Burimi i informacionit për klorofilin a

Të dhënat dhe informacioni mbi klorofilin a janë marrë nga programi Copernicus, i cili mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe synon zhvillimin e shërbimeve evropiane të informacionit bazuar në Satelitin e Vëzhgimit të Tokës dhe të dhëna në vend (jo-hapësinore). Konkretisht, u konsultua Shërbimi i Monitorimit të Mjedisit Detar Copernicus (CMEMS) i cili përdor satelitë “Sentinel” për pjesën hapësinore dhe të dhënat u siguruan në formatin shapefile. U përzgjedh një bazë e të dhënave ditore për klorofilin a e interpoluar me rezolucion hapësinor 1 km², nga viti 2010 në 2020, e nxjerrë nga sensorë të shumëfishtë (MODIS-Aqua, NPP-VIIRS, Sentinel3-OLCI) dhe sensori i vetëm Sentinel3-OLCI Niveli-3 Përqendrimi i klorofilit.

⁸<https://marine.copernicus.eu/>.

2.6.5 Përmbledhje e parametrave të marrë në konsideratë për akuakulturën e peshqve dhe Molusqeve

Më poshtë janë përmbledhur parametrat e marrë në konsideratë për vlerësimin e SHP dhe diapazonet e kushtet e përshtatura për zonat bregdetare të Shqipërisë, duke u paraqitur veçmas për peshqit dhe molusqet (tabelat 24 dhe 25).

Tabela 24: Pasqyrë e të gjithë parametrave dhe përdorimeve të zonës, të marrë në konsideratë për të llogaritur shkallën e pajtueshmërisë në ZPA-të për peshqit.

Çdo parametër renditet sipas diapazonit ose kushteve dhe indeksit të tij të përshtatshmërisë (SI) dhe faktorit të peshimit (K).

Parametrat dhe përdorimet	Niveli i interesit		Faktori i peshimit K
	Diapazoni dhe kushtet	SI	
Batimetria	≤ 30 m	-100	9
	30 - 50 m	1	
	50 – 80 m	0	
	80 – 125 m	-1	
Lloji i shtratit të detit	Livadhet e Posidonia oceanica dhe zona të tjera të ndjeshme	-100	6
	Livadhet e Posidonia oceanica(≤ 400 m)	-100	
	Shtrat ranor dhe lymor	1	
	Substrat i përzier	0	
Zonat e Mbrojtura Detare	Shtrirja e ZMD-së (kategoria II)	-100	7
	Zona e influencës (≤ 1 km)	0	
	Jashtë ZMD-së	1	
Zonat e peshkimit artizanal	Zonat e peshkimit artizanal për aktivitetet e reja	-1	5
	Zonat e peshkimit artizanal për aktivitetet ekzistuese	1	
	Jashtë zonave të peshkimit	1	
Zonat e zhytjes	Në zonat e zhytjes dhe rreth tyre (≤500 m)	1	6 (na)
Shkarkimet e ujërave të përdorur	Shpërndarja e ndotësve ndikon tek aktiviteti (≤ 2 km)	-100	5
	Më shumë se 2 km larg pikës së shkarkimit	1	
Zonat turistike	< 2 km	-1	4
	< 2 km (për aktivitete të vogla/familjare me më pak se 250 t)	0	
	2-4 km	0	
	> 4 km	1	
Largësia nga porti më i afërt	≤ 0.54 nm	-100	5
	≥ 10 milje detare	0	
	0.54nm - 10 milje detare	1	
Grykëderdhjet e lumenjve	≤ 2km nga Lumi i Bunës	-100	5
	≤ 1 km nga lumenjtë e tjerë të Shqipërisë	-100	
	> 2 km nga lumi i Bunës	1	
	> 1 km nga lumenjtë e tjerë të Shqipërisë	1	
Kanalet e lagunave ⁱ	≤ 2 km	-100	5
	> 2 km	1	
Vija bregdetare ⁱ	≤ 300 m	-100	5
	> 300 m	1	
Korridoret detare	≤ 200 m	-100	5
	> 200 m	1	
Tubacionet në det dhe kabllot	≤ 500 m	-	5

Parametrat dhe përdorimet	Niveli i interesit		Faktori i peshimit K
	Diapazoni dhe kushtet	SI	
e telekomunikimit		100	
	> 500 m	1	
Dallgëzimi mesatar	> 3 m	-1	4
	< 1 m	0	
	1 - 3 m	1	
Dallgëzimi ekstrem (stuhi) ⁱⁱ	> 6 m	-1	4
	3-6 m	0	
	< 3 m	1	
Shpejtësia mesatare e rrymave ⁱⁱ	≤ 5 cm/s; ≥ 60 cm/s	-1	8
	5 - 15 cm/s	0	
	15 - 60 cm/s	1	
Temperatura e ujit në sipërfaqe (°C)	≤11; ≥ 30	-1	5
	11-<18; >26-≤30	0	
	18-26	1	

Tabela 25: Pasqyrë e të gjithë parametrave dhe përdorimeve të zonës, të marrë në konsideratë për të llogaritur shkallën e pajtueshmërisë në ZPA-të për molusqet.

Çdo parametër renditet sipas diapazonit ose kushteve dhe indeksit të tij të përshtatshmërisë (SI) dhe faktorit të peshimit (K).

Parametrat dhe përdorimet	Niveli i interesit		Faktori i peshimit K
	Diapazoni dhe kushtet	SI	
Batimetria	<5; >100 m	-100	9
	10 - 30 m	1	
	8 - <10; >30 - 40 m	0	
	5 - <8; >40 – 100 m	-1	
Lloji i shtratit të detit	Livadhet e Posidonia oceanica dhe zona të tjera të ndjeshme	-100	6
	Livadhet e Posidonia oceanica (≤ 100 m)	-100	
	Ranor	1	
	Substrat i përzier	0	
	Shkëmbor, argjilor, lymor	-1	
Zonat e Mbrojtura Detare ^{vi}	Shtrirja e ZMD-së (kategoria II)	-100	7
	Zona e influencës (≤ 1 km)	0	
	Jashtë ZMD-së	1	
Zonat e peshkimit artizanal	Zonat e peshkimit artizanal për aktivitetet e reja	-1	5
	Zonat e peshkimit artizanal për aktivitetet ekzistuese	1	
	Jashtë zonave të peshkimit	1	
Zonat e zhytjes	Në zonat e zhytjes dhe rreth tyre (≤500 m)	1	6 (na)
Shkarkimet e ujërave të përdorur	Shpërndarja e ndotësve ndikon tek aktiviteti (≤ 2 km)	-100	5
	Më shumë se 2 km larg pikës së shkarkimit	1	
Zonat turistike	< 2 km	0	4
	> 2 km	1	
Largësia nga porti më i afërt	≤ 0.54 nm	-100	5
	≥ 10 milje detare	0	
	0.54 nm - 10 milje detare	1	
Grykëderdhjet e lumenjve ^{vii}	≤ 2km nga Lumi i Bunës	-100	5

Parametrat dhe përdorimet	Niveli i interesit		Faktori i peshimit K
	Diapazoni dhe kushtet	SI	
	≤ 1 km nga lumenjtë e tjerë të Shqipërisë	-100	
	> 2 km nga Lumi i Bunës	1	
	> 1 km nga lumenjtë e tjerë të Shqipërisë	1	
Korridoret e transportit detar	≤ 200 m	-100	5
	> 200 m	1	
Tubacionet në det dhe kabllot e telekomunikimit	≤ 500 m	-100	5
	> 500 m	1	
Dallgëzimi mesatar ^{viii}	> 3 m	-1	4
	< 1 m	0	
	1 – 3 m	1	
Dallgëzimi ekstrem (stuhi) ⁱⁱⁱ	> 6.4 m	-1	4
	3-6.4 m	0	
	< 3 m	1	
Shpejtësia mesatare e rrymave ^{iv}	> 50 cm/s	-1	6
	2 - <3; >10 - 5 cm/s	0	
	3-10 cm/s	1	
Temperatura e ujit në sipërfaqe (°C) ^{ix}	<5; >29	-1	8
	5 - <10; >20 - 29	0	
	10-20	1	
Klorofili a (µg/l)	<0.5	-1	9
	>0.5	1	

2.6.6 Kapaciteti mbajtës i prodhimit

Kapaciteti mbajtës i prodhimit është llogaritur në përputhje me konceptet dhe formulën e mëposhtme (përshtatur nga Karakassis, 2013):

$$PCC = [150 + 8(E - 10)] \times f_a \times f_b \times f_k$$

Ku: E = 15 % e hapësirës së ZPA-së⁹

f_a = Koeficienti i largësisë

f_b = Koeficienti i thellësisë

f_k = Hapja/eksponimi i zonës apo rrymave

Vlerat e faktorëve janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 26: Largësia e objektit të akuakulturës nga bregu dhe koeficientët korrespondues të saj. f_a : koeficienti i largësisë, nga 1 në 2

Largësia e objektit nga bregu	< 100 m	101–400 m	401–1000 m	> 1001 m
f_a	1	1.25	1.5	2

Tabela 27: Thellësia nën objektin e akuakulturës dhe koeficientët korrespondues të saj. f_b : koeficienti i thellësisë, nga 0.9 në 2

Thellësia nën objekt	< 20m	21–35 m	36–50m	> 51 m
f_b	0.9	1	1.5	2

⁹Bazuar në një përafrim konservator dhe paraprak, mesatarja e vlerësuar për zonën e okupuar nuk ishte më shumë se 15 %.

Tabela 28: Ekspozimi i zonës dhe koeficientët korrespondues të saj. f_k : koeficienti i hapjes, nga 1 në 2.5

Hapja/ekspozimi i vendndodhjes së aktivitetit	I mbyllur	I hapur	Shumë i ekspozuar	Shpejtësia e rrjedhës
f_k	1	1.5	2	2.5

2.6.7 Plani i monitorimit të mjedisit (PMM)

Për ZPA-të e peshkut sugjerohet hartimi i një plani specifik për monitorimin e mjedisit (PMM).

Duhet të zbatohet një sistem PMM i dedikuar për akuakulturën detare.

PMM duhet të shoqërohet nga një sistem i regjistrimit të të dhënave. Qëllimet e PMM-së janë të mundshme palët e ndryshme që të përmbushin objektivat e sigurta mjedisore, për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë të rezervave të gjalla detare, zhvillim të qëndrueshëm të akuakulturës dhe mbrojtje të habitateve të ndjeshme. PMM do të zbatohet në mënyrë sistematike dhe të përhershme për të shmangur çdo efekt të mundshëm të dëmshëm në mjedisin detar në nivel lokal dhe rajonal.

Më konkretisht, informacioni i siguruar nga PMM do të jetë i dobishëm për:

- minimizimin e ndikimit global të akuakulturës;
- respektimin e shërbimeve ekologjike të siguruar nga ekosistemet;
- minimizimin e ndikimeve në mjedis dhe biodiversitetin në nivel lokal;
- sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloret dhe arritjen e objektivave mjedisore dhe kontributin në mbrojtjen e biodiversitetit;
- sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë në kultivimin e peshkut;
- ndihmën në identifikimin e veprimeve që duhen ndërmarrë për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të aktivitetit të akuakulturës;
- vlerësimin për arritjen e objektivave cilësorë të masave të marra për të mbrojtur mjedisin dhe sjelljen e rezultateve në vëmendjen e shoqërisë civile dhe publikut;
- garantimin e produktit të shëndetshëm dhe cilësor, dhe
- respektimin e shërbimeve të përbashkëta ekologjike të ofruara nga ekosistemet.

Bibliografia

Barazi-Yeroulanos, L. 2010. Sintezë e akuakulturës së peshqve detarë në Mesdhe: një strategji marketingu dhe promovimi. Studime dhe Vlerësime. Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun. Nr. 88 Romë, FAO. 2010: 198 f.

Brigolin, D., Dal Maschio, G., Rampazzo, F., Giani, M., & Pastres, R. 2009. Një model dinamik i popullatës bazuar tek individët për vlerësimin e rendimentit të biomasës dhe flukseve të lëndëve ushqyese përmes një ferme detare të midhjes (*Mytilus galloprovincialis*). Estuarine, Coastal and Shelf Science, 82(3), 365-376.

Buck, B.H. 2007. Provat eksperimentale mbi realizueshmërinë e prodhimit në det të hapur të farës të midhjes *Mytilus edulis* në Gjirin e Gjermanisë: instalimi, kërkesat teknike dhe kushtet mjedisore. Helgoland Marine Research, 61(2), 87.

Cataudella S., Crosetti D., Massa F. (eds). 2015. Lagunat bregdetare në Mesdhe: menaxhimi i qëndrueshëm dhe ndërveprimet mes akuakulturës, peshkimit dhe mjedisit. Studime dhe Vlerësime. Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun. Nr. 95. Romë, FAO. 2015. 278 f.

Corner, R.A., Aguilar-Manjarrez, J., Massa, F. dhe Fezzardi, D. 2018. Perspektivat e shumë palëve të interesuara mbi proceset e planifikimit hapësinor për marikulturën në Mesdhe dhe Detin e Zi. Vlerësime në Akuakulturë, 1–18.

Del Castillo y Rey, F. dhe Macías, J. C. 2006. Zonat me interes për zhvillimin e akuakulturës në bregdetin Andaluzian. Rajoni i Andaluzisë. Ministria e Bujqësisë dhe Peshkimit.

Komisioni Evropian (KE). 2016. SWD (2016) 364 final. Dokumenti Pune i Personelit të Komisionit. Raporti për Shqipërinë 2016. Shoqërues i dokumentit: Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian për Ekonominë dhe Çështjet Sociale dhe Komitetin e Rajoneve. Komunikimi i vitit 2016 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së. I disponueshëm në:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.

Komisioni Evropian (KE). 2018. SWD (2018) 151 final. Dokumenti Pune i Personelit të Komisionit. Raporti për Shqipërinë 2018. Shoqërues i dokumentit: Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian për Ekonominë dhe Çështjet Sociale dhe Komitetin e Rajoneve. Komunikimi i vitit 2018 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së. I disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>.

Komisioni Evropian (KE). 2019. SWD (2019) 215 final. Dokumenti Pune i Personelit të Komisionit. Raporti për Shqipërinë 2019. Shoqërues i dokumentit: Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian për Ekonominë dhe Çështjet Sociale dhe Komitetin e Rajoneve. Komunikimi i vitit 2019 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së. I disponueshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>.

Komisioni Evropian (KE). 2020. Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerimin. Shqipëria. (https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en. Aksesuar në 6 tetor 2020).

FAO. 2012. Rezoluta GFCM/36/2012/1 mbi udhëzimet për Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA). Në: FAO Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun. Raporti i sesionit të 36-të. Marrakesh, Marok, 14–19 maj 2012. Raporti i GFCM. Nr. 36. Romë, FAO. 2012. 71 f.

FAO. 2015. Aktiviteti i akuakulturës në kosha HDPE lundrues. FAO, Dokument Teknik për Peshkimin dhe Akuakulturën. Nr. 593. Romë. 145 f.

FAO. 2018a. Raport i sesionit të 41 të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM), Budva, Mali i Zi, 16–20 tetor 2017. Raporti i GFCM Nr. 41. Romë, Itali.

FAO. 2018b. Gjendja e Peshkimit në Mesdhe dhe Detin e Zi. Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun. Romë. 172 f. Licenca: CC BY-NC-SA 3.0 IGO.

© FAO. Baza e të dhënave FAOLEX. Koleksioni i plotë. Licenca: CC BY-NC-SA 3.0 IGO. Marrë nga: www.fao.org/faolex/opendata. Data e aksesimit: 18/10/2020.

© FAO 2011-2020. Softueri i peshkimit dhe akuakulturës. FishStatJ - Softueri për Seritë e Statistikave të Peshkimit dhe Akuakulturës. Në: Divizioni i Peshkimit i FAO [online]. Romë. Përditësuar në 22 korrik 2020. [Cituar në 14 tetor 2020].

© FAO 2006-2020. Paraqitje e Sektorit të Akuakulturës në nivel kombëtar. Të dhëna. Tekst nga Cobani, M. Në: Divizioni i Peshkimit i FAO [online]. Romë. Përditësuar në 6 mars 2015. [Cituar në 21 tetor 2020].

FAO. 2020. FAO Ditari vjetor. Statistikat e Peshkimit dhe Akuakulturës 2018/FAO annuaire. Statistiques des pêches et de l'aquaculture 2018/FAO anuario. Estadísticas de pesca y acuicultura 2018. Romë. <https://doi.org/10.4060/cb1213t>.

Fourdain, L. 2017. Miratimi i një Zone të Përcaktuar për Akuakulturën (ZPA) brenda planifikimit hapësinor detar në Monastir, Tunizi. Alikante, Spanjë, Universiteti i Alikantes (Studim për MA). I disponueshëm në: <https://rua.ua.es/dspace/handle/10045/78072>

GFCM. 2017. Udhëzime për një Program të harmonizuar të Monitorimit Mjedisor (PMM) për akuakulturën detare në kosha në Mesdhe dhe Detin e Zi. I disponueshëm në: https://gfcmlib.org/SHoCMed%204/3.2%20Survey%20EMP/EMP_updated%20version%20May%202017.pdf?originalPath=aHR0cHM6Ly9nZmNtLnNoYXJlcG9pbmQuY29tLzpiOi9nL0FRL0VjOEE4cXpmeW9OS3JBM3QyWEdiMkljQnpVR0J4TkVrekFuVFVuenpqUW5Canc_cnRpbWU9N0dKUKZYUm4yRWc.

Hishamunda, N., Ridler, N. & Martone, E. 2014. Politika dhe qeverisja në akuakulturë: mësimet e nxjerra dhe progresi. FAO, Dokument Teknik për Peshkimin dhe Akuakulturën, Nr. 577. Romë, FAO. 59 f.

Holmer, M., Argyrou, M., Dalsgaard, T., Danovaro, R., Diaz-Almela, E., Duarte, C. M., Frederiksen, M., Grau, A., Karakassis, I., Marbà, N., Mirto, S., Pérez, M., Pusceddu, A., Tsapakis, M. 2008. Efektet e mbetjeve nga aktiviteti i akuakulturës mbi livadhet e Posidonia oceanica: sinteza dhe sigurimi i mjeteve të monitorimit dhe menaxhimit. Buletini i Ndotjes Detare 56 (9). 1618–1629 f. I disponueshëm në: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0025326X08003160?via%3Dihub>

Karakassis, I. 2013. Ndërveprimet mjedisore dhe iniciativat për zgjedhjen e zonës dhe vlerësimin e kapacitetit mbajtës për kultivimin e peshkut në Mesdhe. Në: L.G. Ross, T.C. Telfer, L. Falconer, D. Soto & J. Aguilar-Manjarrez, eds. Zgjedhja e zonës dhe kapacitetet mbajtëse për akuakulturën bregdetare dhe në ujërat e brendshme, f. 161–170.

FAO/Instituti i Akuakulturës, Universiteti i Stirling, Takim i Ekspertëve, 6–8 dhjetor 2010. Stirling, Mbretëria e Bashkuar, Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut. FAO, Procedurat e Peshkimit dhe Akuakulturës, Nr. 21. Romë, FAO. 282 f.

Kashta, L. 2010. Vlerësimi i Mangësive në Zonat e Mbrojtura, Biodiversiteti Detar dhe Legjislacioni për Zonat e Mbrojtura Detare – Raporti Final. [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Protected Areas Gap Assessment.pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Protected%20Areas%20Gap%20Assessment.pdf).

INCA. 2013. “Plan strategjik për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare (SPMCPA)” hartuar me mbështetjen e UNDP në kuadër të Projektit “Përmirësimi i mbulimit dhe efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare”.

Komiteti Drejtues Ndërkombëtar për Hartëzimin Global, Shqipëri. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor. Portet, Shqipëri. 2016. - TexasGeoDataPortal. Nuk jepet shkalla. <https://geodata.lib.utexas.edu/catalog/stanford-yk042cv3869>

Le Gouvello R, Hochart LE, Laffoley D, Simard F, Andrade, C., Angel, D., Callier, M., De Monbrison, D., Fezzardi, D., Haroun, R., Harris, A., Hughes, A., Massa, F., Roque, E., Soto, D., Stead, S., Marino, G. 2017. Akuakultura dhe zonat e mbrojtura detare: Mundësi dhe sinergji potenciale. Aquatic Conserv: Mar Freshw Ecosyst. Vol 27:1–13.

Macias, J.C., Avila Zaragoza, P., Karakassis, I., Sanchez-Jerez, P., Massa, F., Fezzardi, D., Yücel Gier, G., Franičević, V., Borg, J.A., Chapela Pérez, R.M., Tomassetti, P., Angel, D.L., Marino, G., Nhalla, H., Hamza, H., Carmignac, C. & Fourdain, L. 2019. Zonat e përcaktuara për akuakulturën: një udhëzues për caktimin e zonave bregdetare kushtuar akuakulturës në Mesdhe dhe Detin e Zi. Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun. Nr. 97. Romë, FAO. 90 f.

Marino, G., Petochi, T., Cardia, F. 2020. “Përcaktimi i zonave detare për akuakulturë (ZPA). Udhëzues”, 245 f., dokumente teknike ISPRA 2020 - ISBN 978-88-448-1014-6 (në hartim e sipër).

Massa, F., Onofri, L. dhe Fezzardi, D. 2017. Akuakultura në Mesdhe dhe Detin e Zi: perspektiva e Rritjes Blu. Në: Manual mbi Çështjet Ekonomike dhe Menaxhimin e Oqeanëve të Qëndrueshme. Redaktuar nga Nunes P.A.L.D., Svensson, L.E. dhe Anil Markandya, A. Edward Elgar Publishing. 624 f.

Niță, V., Massa, F., Nicolaev, S., Fourdain, L., Nenciu, M.I. 2020. Vlerësimi i përshtatshmërisë së zonës Agigea - Eforie për miratimin si Zonë e Përcaktuar për Akuakulturë (ZPA) dhe për Zbërthimin e Potencialit të Marikulturës në Rumani 2020. “Cercetări Marine”, numri 50 (në publikim e sipër).

Rajkovic, Z. dhe Kromidha, G. 2014. Plani i Menaxhimit për Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. UNDP, 128 f. + Shtojcat.

Republika e Shqipërisë. 2005. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria e Peshkimit. Rregullore nr. 1, datë 29.3.2005 “Për zbatimin e legjislacionit për peshkimin dhe akuakulturën”.

Republika e Shqipërisë. 2008 Ligji nr. 9863/2008 “Për ushqimin”.

Republika e Shqipërisë. 2009a. Ligji nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Republika e Shqipërisë. 2009b. VKM nr. 538/2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, sipas ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Republika e Shqipërisë. 2009c. [Rregullore nr. 8, datë 11.11.2009 “Për masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”](#).

Republika e Shqipërisë. Udhëzim nr. 25/2010 “Për kushtet higjienike dhe kontrollat për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”, sipas ligjit 9863/2008 “Për ushqimin”.

Republika e Shqipërisë. 2011. Ligji nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Republika e Shqipërisë. 2012a. Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Republika e Shqipërisë. 2012b. Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin”.

Republika e Shqipërisë. VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, sipas ligjit nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Republika e Shqipërisë. 2016. Ligji nr. 103/2016 “Për akuakulturën”.

Republika e Shqipërisë 2018. Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”

Sánchez-Jeréz, P. dhe I. Karakassis. 2011. Zona e lejuar e efektit (ZLE) për akuakulturën detare në Mesdhe (WGSC-SHoCMed). Dokument i papublikuar GFCM:CAQ/2012/CMWG-5/Inf.11., aksesuar në 14 tetor 2020 në: http://gfcmsitestorage.blob.core.windows.net/documents/web/CAQ/CMWG/5/GFCM_CAQ_2012_CMWG-5_Inf.11.pdf.